

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8SH-32

985



LLAZAR ÇUÇI

një fluturim
i zakonshëm

891.983-32

S

ES

BIBLIOTEKA E RINISË

LLAZAR ÇUÇI

NJË FLUTURIM
I ZAKONSHËM

Tregime, reportazhe, skica)

~~57263~~

663



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

PILOTI I FERMËS

Gjatë tërë fluturimit, që kishte zgjatur afro një orë, pilotin e patën mbuluar kujtimet e fluturimeve luftarake me aeroplanin gjuajtës. Kushedi sa herë kishte kaluar ai në këto anë, përmbi këto male, që e ruajnë dëborën gjer në mesin e verës. Me gjuajtësin kjo qe punë minutash, kurse tani i dukej se fluturonte në një qerre ajrore, që mezi e tërhiqnin buajt, ndonëse aeroplani i tij kishte një motor të mirë, me njëmijë kuaj fuqi. Nga dymijë metra lartësi, toka poshtë i dukej thuajse e palëvizshme. Objektet, të mëdha e të vogla, mezi rrëshqisnin nën krahët e aeroplanit të ngathët. Diku, në thellësi të hapësirave të jugut, ai dalloj dy gjuajtës që çanë qiellin si shigjetë dhe humbën në horizont...

... Pasi kishte marrë paaftësinë për të fluturuar me gjuajtës, atij i qe dukur se me kaq puna në aviacion mbaroi dhe i duhej thënë lamtumirë qiellit! Ku të shkonte? Të kthehej prapa nga aeroplani supersonik e të fluturonte në tipa të tjerë? Por kjo është njësoj si të lësh traktorin e të zësh parmendën... Kjo ta bën zemrën vrer...

Kështu i pati dhënë karar kësaj pune, duke vendosur të largohet një herë e mirë nga qielli dhe të ruante si gjënë më të shtrenjtë në jetë fluturimet me shpejtësi të mëdha.

— Mendohu edhe një herë, — i kishin thënë dhe i patën propozuar të fluturonte në aeroplanë transporti ose në helikopterë dhe ja numëronin tipat me radhë, duke i bërë edhe nga një çikëz politike për se cilin tip.

Ai, i ndezur prush nga ironia e fatit, tundte kokën pa lëshuar zë. Në ata sy të zinj e të plogët filloi të zërë vend një farë dhembje e trishtimi së bashku. Ngjante sikur ata sy, me vështrime të ngathta, që dëndur rrëzoheshin në tokë, i drejtoheshin kujtdo me një lutje: «Mos më bini më qafë».

Ai nuk ishte ndonjë tip karrieristi. Jo. Madje e dinte fare mirë se shumë aviatorë ky fat i pret, meqë në atë profesion çdo gjë varet nga gjendja shëndetësore. Mirëpo ju dukën para kohe gjithësa ngjanë papritur. Nuk po mësohej dot të bënte një copë rrugë, kur me mendje kishte vendosur t'ja linte jetës zgjidhjen, siç bëjnë njerëzit kur u mungojnë fuqitë.

Sytë e tij shprehnin pareshtur atë lutjen «Më lini rehat. . .» që ju bë zakon edhe në detyrën e re, ndërsa vështrimet zunë të përpinin kupën e qiellit, sapo që atje lart të ndihej ndonjë vuvurimë motori.

«Mos më bini më qafë, atje është jeta ime. . .»

«Ke nevojë për ndihmën tonë? . . . Qysh të të ndihmojmë. . .?»

«Do të iki. Nuk e kam mendjen për kësi punësh. . .»

«Ke nevojë për ndihmën tonë?..»

«Faleminderit...»

«Duhet luftuar edhe insektet e dëmshme, — mendoi piloti. — Duhet spërkatur pemët. S'ke ç'i bën...»

«Ja edhe aerodromi», tha me vete dhe pakësoi gazin. Motori sikur e humbi fare uturimën. Aeroplani u var më poshtë. Toka rrëshqiste më shpejt nën krahë. Lartësia sa vinte bëhej më e vogël. Tani, në tokë, çdo send mori konture të qarta. Në anë të aerodromit, piloti vuri re se kishte njerëz. I shikoi me kujdes. Ata qenë mbledhur pranë e pranë.

«Fëmijë», — tha.

Aeroplani rrëshqiti mu përpara grumbullit të njerëzve dhe ca më tutje, si ndonja pesëdhjetë metra larg tyre rrotat ndeshën me tokën. Toka i shtyu rrotat me gjoksin e saj dhe aeroplani kërceu përjetë një herë, dy, tri... Gjersa shpejtësia u shua.

— E, hej! Si cjaq kërcen, — thirrën fëmijët.
— Si cjaq. E, patë?

Aeroplani kishte ecur nëpër bar dhe qe afruar tek vendi ku do të pushonte për ca kohë. Motori reshti dhe nga dera doli ekipazhi. Tekniku, sapo vuri këmbën në tokë, zuri të vinte përqark aeroplanit, duke e shikuar me kujdes, ndërsa piloti bariste plogët nëpër barin me vesë, drejt fëmijëve.

«Ja ku erdha më në fund», tha me vete dhe shtoi: «Ku do të jetë ferma? Fusha e betejës, ku do jetë?.. I erdhi radha pilotit të luftojë me mizat e krimbat...»

— O pilot! — dëgjoi një zë fëmije. — Pse kërcenve ashtu? Ç'pati aeroplani që u hodh si kec?...

Hodhi sytë përçark. Vështrimet e tij sikur shprehnin ende atë lutjen: «Mos më bini më qafë, bre!»

Lajmi se atë ditë në aerodromin e ri fushor do të zbriste një aeroplan, ishte përhapur në gjithë qendrën e banuar aty pranë. Vargu i njerëzve që vinin drejt aeroplanit s'kishte të sosur. Të parët patën mbërritur të organizuar fëmijët e shkollave. Dy mësuesit rrinin në mes tyre dhe u shpjegonin me aq sa u merrte mendja. «Po, pse kërcen?... Pse u hodh?...»

Atë kohë piloti u turpërua. Ai sollti në mend se kishte kaluar pranë njerëzve pa u folur, pa u thënë së paku «mirëmëngjez»; pastaj kujtoi uljen e pakujdeshme që kishte bërë. Nuk i mbeti gjë tjetër, veçse të buzëqeshte e të ledhatonte fëmijën e zgjuar e të shkonte më tutje, nëpër aerodromin fushor, duke tërhequr zvarrë këmbët e plogëta.

Një «gaz» i vjetër u var nga xhadeja në fushë me rrëmbim.

— Për fermën keni ardhur? — pyeti një burrë i gjatë zeshkan, me kasketë nga ato të fëshfësheve, pa dalë mirë nga «gazi». Piloti qeshi sa për t'u dukur.

— Po, unë jam piloti i fermës...

Ata që zbritën nga maqina u përçafuan me pilotin si miq të vjetër. Edhe shoferi, me një xhaketë kadife tërë njolla vaji e benzinë, ju hodh në qafë. Ai e ndjente veten më afër me pilotin, se që të dy mbanin erë benzinë. Ai burri i gjatë zeshkan, me atë kasketën fëshfëshe në kokë, zuri të fliste për detyrën që e priste pilotin. Herë pas here ai fuste në bisedë edhe drejtorin, edhe ministrinë.

Zinte në gojë dendur pentoren prej afro njëmijë hektarësh, aeroplanin, motopompat, helmet që do përdroreshin në spërkatje dhe tregonte se si mund të bëhej fluturimi.

Ndërsa piloti dëgjonte duke vështruar kot së koti në një pikë dhe thoshte me mendje:

«Erdhi puna të më japë urdhëra e udhëzime një njeri, që s'ka haber nga aviacioni».

Ai ishte mësuar me shefat e tij ushtarakë, që kishin përvojë të madhe në fluturime.

— Si thoni? Fillojmë?!... — ja bëri më në fund ai me kasketë fëshfëshe.

«Siurdhëron! Piloti i fermës nën urdhërat tua-ja». — desh të thoshte aviatori me zemër të vrrarë. Ai psherëtiu dhe u nis për tek aeroplani. Këmbët e plogëta i hiqte zvarrë. U ngjit me përtesë në kabinë. Aty u kujtua të pyeste teknikun në e kishte mbushur depozitën me lëndën helmuese.

— Çdo gjë gati! — u përgjegj me zë të lartë e me fytyrë tërë ngazëllim tekniku.

Brenda në kabinë kishte hyrë edhe ai me kasketën fëshfëshe.

— Do të vij edhe unë... Jam agronom... — ja bëri i pavendosur.

Piloti tundi vetëm kokën, sikur desh t'i thoshte «si të kesh qejf...»

Pas pak u dëgjua gumëzhima e parë e motorit. Aeroplani u ngrit dhe fluturoi në kurset jugore, në lartësinë nja njëqind metra. Aviatori vuri re se përmbi kabinë i kaloi një lejlek i plogët. «Lejlekët fluturojnë më lart se mua...» mendoi dhe rrudhi buzët.

S'kaluan as pesë minuta dhe agronomi që rrinte

më këmbë, mezi ngriti dorën, për të treguar diçka përpara.

— Ferma jonë... — zuri të thërriste me zë të lartë, për të mposhtur zhurmën e motorit. Tregohet i qetë. Mendohej të rrëfente kufitë e plantacioneve të pemtores. Mirëpo rrymat vertikale të ajrit, që e vërvitnin aeroplanin lart, poshtë, ja zinin fjalën në grykë e s'e linin rehat.

— Jemi lart më ngjan... Kështu shpërndahet shumë helmi... nuk bie fare... Ca më ulët... — fliste agronomi, me zë të çjerrë.

Piloti s'kishte nga të merrej me fjalë dhe s'ja kishte qefi të dëgjonte atje, në ajër, një njeri që s'merrte vesh nga fluturimi. Ai tundte vetëm kokën i mërzhitur. Kështu bëri gjersa mbaroi hedhjen e helmeve dhe mori prapë lartësinë nja njëqind metra. Aty nuk duroi më:

— Ti, agronom, mos më tërhiq vëmendjen, kur jam ulët. A, merr vesh ti ç'do me thënë të fluturosh pesë metra mbi pemë... dhe plepa e kodra përçark?... Pastaj ç'më thua: më ulët ca!... Kupton ti se me këto rryma vertikale, që ngrenë e ulin pa të keq afro gjashtë tonë, mund të përqafojmë mollët e të puthim tokën?!!
Dhe mendoi: «Do më lini rehat apo jo?»

Ca nga uturima e motorit, që nuk e la të dëgjonte mirë, dhe ca ngaqë nuk e kuptonte si duhet gjuhën e pilotit, agronomi humbi në heshtje.

Sapo zbritën në aerodrom, aviatori tha:

— Shkojmë një herë nga pemtorja.

Agronomi qeshi, i hodhi dorën supeve tjetrit dhe ashtu pranë e pranë ndezën nga një cigare, duke ecur buzë xhadesë, nëpër hije. Pas pak u fu-


tën në pemtore. Aviatori shikonte radhët e drejta të mollëve dhe nga do që hidhte sytë i vinte çudi. Sa të gjatë e të pafund i dukeshin ato radhë këtu, në tokë! Ndërsa atje lart, nga ajri, ai s'do ta besonte kurrë po ti thoshin se ferma ka plantacione të atilla, ku mund të humbasësh. Për një çast harroi fare pse kishte hyrë në mes të atyre pemëve. Ashtu i hutuar çapitej pas agronomit. Befas që prapa ndjeu një shkrofëtinë kali. Bëri mënjanë dhe atë kohë i ra në mend që të shikonte fletët e pemëve. Agronomi, ca më tutje, po kontrollonte.

— Ej, ç'kërkoni atje! — u dëgjua një zë i ngjirur. Një karro kishte ndaluar në rrugicë. Karrocieri plak thërriste pa ndroje.

— Ç'kërkoni atje? Pse aq kollaj gjendet pika e parë e vesës? Hajde, mendje, hajde! Edhe ti, agronom, pa le. . .

Qeshën që të tre. Agronomi lajmëroi të sillnin shpejt mikroskopin. Ai, ngaqë s'dinte ç'të bënte, zuri me dorë kasketën, po s'e hoqi nga koka.

— S'keni ç'e doni as mikroskopin. . . Ky është ai piloti? — ja bëri karrocieri plak dhe shtoi: — Hajde ç'shpejtësi e ç'uturimë! Më shkove mu përmbi kokë. Thashë se më përpiu aeroplani. Pela u çakallos fare e thashë se më gremisi. Mezi e qetësova dhe vetë e futa kokën mu në mes të gjunjëve. Aeroplani u zhduk majave të pemëve; po ajo perde tymi, që linte pas, më mbuloi. Ja, mu këtu isha, tek mollët. Thashë, kaq e pata unë me pelën, u helmuam. Kur vura pëllëmbën në kokë ndjeva lagështi. E vura mbi vithe të pelës, prapë ndjeva lagështi. Kaq e patëm thashë, e hëngrëm helmin. Thirra ca të rinj, se mua s'më shohin sytë. «Xhaxha, pela



Piloti i fermës

e zezë të është kthyer në kërre... ç'të gjeti kështu? Ik e pi qumësht dhe jepi edhe pelës, se u helmuat, o Xhaxha», — më qeshën ata...

Agronomi dhe piloti kishin qëndruar nja dy hapa larg karros dhe dëgjonin, pa bërë asnjë lëvizje, tregimin gazmor të karrocierit plak.

— Hajdeni, hipni t'ju gjezdis nga punëtorët.

Karrua u nis. Piloti u ul pranë karrocierit, që diçka kërkonte të nxirrte nga xhepi.

— E kanë menduar mirë. Me aeroplan i dilet mbanë kësaj... Hajde, hajde, si shkonte! Fërtymë!... Ki mendjen, ama, djalo, se ku i dihet, në ajër je...

Karrocieri e shikonte në bebe të syrit pilotin, sikur kërkonte që të hynte thellë në shpirtin e tij.

— E pi duhanë? Na, dridhe... shiko si i ngrenë duart për ty. Shiko çupat si i tundin shamitë për ty. Bën punë të madhe ti me aeroplan... Fërtymë...

Agronomi qe kthyer prapa, në bisht të karros, dhe, duke ruajtur gëzimin përbrenda, lëkundej nën troshitjet e karros.

Larg, në rrugën tërë pluhur, vraponte një vajzë e re, me fustan bojë qielli, që mbante në dorë një mikroskop për agronomin dhe pilotin.

KUR DO TA FESTOJMË VITIN E RI?

Q ielli që kishte qenë i zymtë, disa ditë me radhë lëshonte bashkë me shiun edhe ato reflekse të hirta e të mërzitshme. Që në mëngjez e gjer në mbrëmje të bëhej sikur ishte mbuluar nga një çarçaf i tymosur e i qullët. Edhe atë ditë moti nuk ndryshoi thujse fare për mirë, veçse u keqësua. Zunë të shkrepnin rrufe e të kërcisnin bubullimat, si në shirat e prasmë të pranverës. Më në fund ja tek po dilnin të vërteta stuhitë e parashikuara nga sinoptika.

E, me gjithë këtë mot të keq e qiell të mërzitshëm, ajo në ecje e sipër e kishte mënjanuar çadëren për të parë lart. Çurgat e pareshtura të shiut i kishin njomur fytyrën dhe ajo lëpinte buzët plotë bula. Filloi shiu, ndërsa ajo, si shumë të tjerë, ëndërronte për të patur kohë të mirë në këtë mbrëmje të Vitit të ri. Dhe gëlonin njerëzia nga të katër anët: shesheve, rrugëve, trotuarëve. Ndërsa diku e vëzhgonin ndryshe qiellin. E vërenin me kujdes, e studjonin me qëllime të caktuara. Ndërkaq, morsi niste geramat flutuese në efir, duke

i përcjellë me tinguj alarmues: Në zonën X 200 milimetra shi... Nivelin e lumenjve... Kërcënon vërshimi...

Trotuareve ecin ngutshëm. Ngrenë kryet, vështrojnë qiellin dhe rrudhin buzët, se nuk shpresojnë më që të ketë një mbrëmje siç ta do qejfi. Mbrëmja bie pa u ndjerë, se e tërë dita ka qenë një muzg i vërtetë. Neonet ngjajnë si xixëllonja të shtypura në një tavan të murmë. Ato lëshojnë mbi trotuar nga një njollë të mekur drite. Ajo u ndal menjëherë tek njolla e dritës aty pranë hyrjes, u përkul e fshiu pulpët e këmbëve me shami. Takat trokitën sërishmi trotuarit dhe ajo ndjen më thellë në atë trokitje vetminë, gjer brenda në sallë. Aty ju bë se shumë sy i hodhën shikime nga këmbët tek koka. Dikush i vuri në dorë një copë letër të palosur me kujdes.

«Mos më prit sonte. Jam në shërbim.
Gëzuar! A».

Traku i takave e ndiqte nga pas. Këtë radhë vetmia e tyre ndihej më shumë. Rrugët e trotuaresh këmbëve zbratur.

Një autobus urban doli me shpejtësi nga kthesa e mori bulevardin e gjerë.

— Ela! — u dëgjua një zë vajze, që thirri nga autobuzi. Shushurima e rrotave e mori tutje zërin, me vete. Ajo as që e lodhi mendjen të kujtonte se i kujt ishte ai zë. Me siguri do të qe ndo një shoqe e fakultetit, nga ato që do ta festonin mbrëmjen e Vitit të ri në konvikt.

Atë kohë ajo kishte ngritur kokën dhe kishte ndjerë se shiu bënte punën e tij. Binte ashtu si gjithë ditën pa prerë, ngadalë e i mërzitshëm sa

s'bëhet. Flokët i qenë bërë qull. Ata tërhiqnin pikat e ujit dhe i lëshonin rreth qafës.

«Si u hutova kështu?»

Ela hoqi çadëren nga sjetulla, e hapi dhe ashtu mendueshëm e la t'i qëndronte thujse varur mbi shpatulla. Sytë i mbante përdhe aty pranë, ku i shfaqeshin majat e këpucëve, me nga një xixë të thellë neoni. Në ecje e sipër i ngjante sikur e hidhte atë xixë nga njëra këmbë në tjetrën.

«Sa papritur mu afrue!» mendoi.

Edhe atë pasdite të vonët shtatori ajo ecte nëpër bulevardin e gjerë, po ashtu kokulur, siç e kishite bërë zakon. Hera-herë, kur çonte sytë përçark ndjente thellë në gjoks zverdhëllimën vjeshtake që e rrethonte. Ndërsa që larg i shfaqej horizonti ngjyrë-vjollce e ipërtymur i maleve. Trokitja e takave i shkante pas vetiu. Kjo troktije dhe mendimet e vashërisë nuk e patën lënë kurrë vetëm.

Si të gjitha vajzat në moshë, edhe ajo kishte ëndërruar për shokun e jetës. Dhe ashtu si shfaqeshin në sytë e mendjes, si nëpër mjegull tiparet e djalit, ashtu i dilte edhe profesioni i tij.

Herë i bëhej se që flokëzi, vetullzi, syzi, herë bjond e sykaltër e ndonjëherë i turbullt e pa ngjyrë. Ai duhej të ishte ndonjë inxhinier, apo agronom, mjek, mund të ishte, një elektrikist, një poet ndoshta, por asaj i besohej se do të që një i ri që i bën të gjitha, të gjitha. Dhe ajo zuri ta ndjente afrimin e tij gjithnjë e më shumë, e pështjellë nga një afsh i panjohur, i paprovuar.

Atë pasdite vjeshte çdo gjë kishte qenë e bukur gjer përtej në horizont... Edhe qielli... Ndërsa ajo e hidhte vështrimin e vagëlluar jo më larg

nga bedeni i maleve. Më lart nuk shkonte kendi i vështrimit të saj. Ç'i lipsej hapsira boshe e qiellit? Edhe kur atje lart fluturonte dikush me supersonik, asaj nuk i pati bërë ndonjëherë përshtypje të veçantë. Zhurmat e tyre i ndiqte me mendje e thoshte:

«Fluturojnë shpejt. Nuk arrin të ngresh këmbën. Ku e gjen dot nëpër qiell...»

Trokitja e takave ja ndiqte pas mendimet; ai me siguri do të gjente mënyrën se si t'i buzëqeshte, të këmbente dy fjalë, të njihej e pastaj... pastaj të thoshte atë fjalë të zakonshme «të dua». Këto prireshin sipas radhës...

Ajo ndjeu mornicat tek i mbuluan trupin. Ju bë se aty pranë trokisnin nëpër trotuar ca taka të rënda. Aty herë afroheshin, herë mbeteshin prapa. Dëgjoheshin herë majtas, herë djathtas. Po, po, ajo e kuptoi fare mirë se trokitja e vetmuar e takave të saj po merrte fund.

— Më falni. Dy fjalë dua t'ju them...

Kishte qenë, pra, një njeri i beftë. Një i ri i etshëm për veprim, që i bënte të gjitha pa ceremoni. Kishte qenë një aviator dhe asaj nuk i paskësh shkuar kurrë në mend se shoku i jetës do të zbriste kështu papritur si nga qielli e do ta linte gojëhapur.

Ai vinte dhe ikte përsëri, ashtu pa u kuptuar. Gjatë këtyre muajve ajo fare pak ishte fjalosur me të.

— Aeroplani supersonik le një vërshtëllimë prapa...

— Po. Ndonjëherë edhe kërcëllima shurdhuese. Kjo ndodh kur çan barrierën e zërit...

— Ndërsa aeroplani i ngadalshëm ose helikopteri yt, duke vozitur me zor nëpër qiell, lëshon «rënkime motorike».

— Si the?

— Rënkime motorike...

— Nuk është e drejtë.

— Pse? — kishte pyetur ajo me mospërfillje, duke mbajtur sytë përdhe tek majat e këpucëve.

— Domethënë, figurë jo e saktë, — ja bëri ajo më në fund, po ashtu kokulur, duke fryrë nja dy fije floku që i gudulisnin buzët.

— Jo, nuk është aty puna. Thashë se, nga ana ime, si pilot, e quaj këngë motorike. Jetë! Ndoshta simfoni. Jam i lidhur mjaft me atë këngë, se ajo më jep krahë. E kështu, po thashë «rënkime», duhet t'i mbledh krahët e të zbres në tokë, sa nuk është vonë...

Kjo duhet të kishte qenë biseda e tyre më e gjatë... Morsi nisi në efir shkronjat fluturuese me tinguj alarmues, përzier me shi. Lumenjtë shpërthejnë...

Mbrëmja e Vitit të ri tërhiqej zvarrë nëpër shirat e murmë. Ela ecte më nge nëpër trotuarët e zbrazët. Trokitja e vetmuar e takave e ndiqte pas. Tek dëgjonte atë trokitje mudohej të dëgjonte «këngën motorike» që shpështillej mbi kokën e aviatorit. Ajo zuri ta ndiqte atë këngë gjithnjë e më shumë. Atë çast ju bë sikur takat e saj po trokisnin në një kapak gjigant prej metali. Dhe ata tinguj, sapo dilnin së poshtmi, i pushtonin gjoksin, zemrën, mendjen. Ajo këngë e mbajti me rithmin e saj dy ditë me radhë.

Shirat mbaruan. Niveli i lumenjve ra. Vërshi-

met aq e patën. Ata ecin mu në mes të bulevardit. Polici u bën shenjë: hipni në trotuar, ju lutem! Mos ecni kokulur, se rrezikoheni!..

Ajo dëgjon me vëmendje:

—... Më i vjetri i familjes, një plak rreth tetëdhjetë vjeç, nuk hipi në helikopter. Ne kujtuam se nuk hipën dot. Zbriti një pilot dhe tekniku që ta ngrinin. Por plaku kundërshtoi «Jo, — tha. — Mirë jam këtu. S'më gjen gjë mua, jo». Familja që ishte në helikopter hem gëzonte që shpëtoi, hem qante për plakun... Kur shkoi fjala në vesh të shokëve të partisë, sakaq erdhi urdhëri: «Të merret plaku që andej»... Edhe ajo familje mbeti pa festuar Vitin e ri.

Kështu tregon aviatori.

Ndërkaq në bulevardin e gjerë, si një pistë aerodromi, bie një mjegull e kaltër, që ndehet si perde tyli mbi neonët.

— Më mirë të kishim vajtur në mbrëmjen e datës njëzetepesë në «Internacional.»

— Ku ta dinim se ç'do të ngjante...

— Jo, edhe mua më pëlqente në Shtëpinë e ushtrisë...

— Unë them se na nuk do ta harrojmë atë mbrëmje.

— Po, kur do ta festojmë Vitin e ri?

Ajo u afrua më pranë tij.

Atë kohë, para tyre kaloi një çift hipur në biçikleta. Ela ndjeu tek ju ngjitën nëpër pulpët e këmbëve, stërpikat e ftohta. Ndanë trotuarit, në krye të kthesës, çifti zbriti nga biçikleta. Dy kokat e tyre u afruan dhe ndenjën pakëz ashtu, si dy pëllumba sqep më sqep.

~~57263~~

TEK
GJËSHKRUAR

663



Kur do ta festojmë Vitin e Ri

Ela ktheu kokën mënjanë dhe vështrimet e tyre u puqën si dy transfokatorë që shikojnë në kënde të kundërta.

— Në Novoselë na kanë ftuar të festojmë 11 Janarin. Si thua? «Sa mirë është të kesh përpara një festë!..»

ËNDËRRA E AVIATORIT SULO

Ato ditë bënte të ftohtë i hidhur, ndërsa lulet e bajameve, të gënjyera, të ndillnin trishtim tek i shikoje si binin nën hovet e erës.

Qielli dukej i pastër, i ndritshëm, i qetë. Vetëm horizontet qenë veshur nga një brez i murmë. Por ky qiell atje lart paskësh qenë i shqetësuar, i mbushur me lëkundje vertikale e horizontale të ajrit. Kurse horizonti prej së larti ngjante i hapur, i gjerë dhe toka e rrudhur, e rëndë e pështjellë nga qetësia. Ndodhte, pra, e kundërta për aviatorin që pak çaste më parë gjendej në ajër dhe tani çapitej nëpër tokë. Na qenkëshin dy përshtypje të rreme si për qiellin, ashtu edhe për tokën. Asgjë reale nga ajo që shikon. Këto përshtypje bluante ai tek bridhte poshtë e lart atyre rrugëve plot traga, përpara agjensisë. Era sulej nga të katër anët e ulërinte nëpër strehët e godinës. Dera, që kishte një bravë të sakatosur, pa dorezë, gërvinte paprerë si e ngjirur. Njerëzit hynin e dilnin me potere nga ajo godinë, pa çarë kokën për asgjë tjetër, veç të gjenin sa më parë një mjet gjer te stacioni trenit, që ishte një orë

larg prej aty. Sikush përpiquej të nisej i pari, duke i dhënë hak vetes si njeri me një barrë halle shtetërore, pa le pastaj personale, si fjala vjen një shportë me vezë, që ta çonin shpirtin në majë të hundës gjersa të mbërrinin në destinacion. Ndërsa ai udhëtonte vetëm për t'u kthyer në shtëpi dhe asgjë më tepër, ndaj nuk e prishte qetësinë dhe e kalonte kohën duke rikujtuar ngjarjet e asaj dite.

Që në mëngjez heret ishte ndarë nga shtëpia si për udhë të gjatë, ndonëse gjithë-gjithë ajo merrte vetëm pesë orë me tre mjete komunikacioni: aeroplan, autobuz, tren. Një orë udhëtim fluturimi përfundoi siç qe parashikuar, veçse nëpër një ajër të egërsuar, plot tallaze, që e vërtitnin aeroplanin sipas qejfit, po të mos kishte një njeri pranë aparateve të drejtimit. Dhe ai po e ndjente edhe tani djersën e atij fluturimi të gjatë, të ftohtë, midis shpatullave. Nga kjo, ai bënte ç'bënte lëvizte, pa qendruar dy minuta në një vend, pështillte fytin me shallin gri, tundte pa kujdes një çantë të vogël që mbante në dorë, dhe herë pas here, tek rrinte gjëkund, përkulte trupin sikur të ushtrohej në gjimnastikë. Kishte një copë herë të gjatë që kur se zuri të priste mjetin e dytë të udhëtimit, madje duhet thënë se ky mjet kishte ikur sipas orarit, kështu që pritej maqina e rastit. Kjo vonesë e bënte të mendonte e ta vinte në dyshim trenin, mjetin e tretë të udhëtimit të asaj dite me atë erën e ftohtë kallkan, që shponte edhe kapotën ushtarake. Para një ore, ky njeri e shikonte tokën që për së larti dhe ndjente prej andej mallin e ndarjes, sadoqë ai do të takohej prapë me të së shpejti. Natyrisht këtë mall ja shton-te ajo gjendje turbullire që zotëronte në qiellin e pa-

besë. Sa të ulem, kishte menduar aviatori, sapo në kurset lindore u shfaq aerodromi i uljes. Sa kohë që fluturonte, përshtypja e qetësisë së tokës nuk i qe ndarë, ashtu si dhe ajo për qiellin, tek e shikonte nga poshtë; po që të dyja ishin përshtypje të rreme.

Siç bënëin gjithë udhëtarët nevojtarë, edhe ai qe sulur disa herë drejt maqinave, u jepte shenjë shoferëve se kërkonte vetëm një vend dhe atë gjer tek treni. Mirëpo edhe ora e trenit shkoi e vate, fërshëllimat e tij nuk harrinin gjer aty, në atë agjenssi të humbur, por aviatorit ju bë se i dëgjoi ato tek jepnin sinjalet e fundit, të cilat sikur donin të thoshin: «S'pres më. S'pres më. S'pres më». Në atë kohë ai e ndjen më shumë të ftohtit dhe shikon dendur e më dendur orën, që pas këtij çasti zuri t'i dukej se ngeci në vend. U dëshpërua, ose, të paktën, sikur u mierzit ngaqë puna e mjetit s'po i shkonte mbarë. Një copë herë nisi të tundte kot më kot atë dorën ku mbante çantën e vogël ngjyrë kaki. Ndërkohë një «zis» riportabël u gjend papritur e me rrëmujë aty pranë, shoferi se ç'foli me dikë dhe nuk vonoi t'i përgjigjej edhe aviatorit, duke i treguar me duar dy femrat që kishte në kabinë!» «Më vjen keq, po s'kam ç'bëj... Siç e shikon, emancipimi, vëlla...» dhe, si shkëmbyen nga një vështrim buzagaz, u ndanë. Ndërkaq andej nga peshorja, prapa godinës, një thirrje, përzier me ulërimën e erës së marrë, i erdhi gjer në veshët, e ngjirur, e çjerrë:

— Ç'ke ndër mend të bësh? Do të presësh ndo një veturë, apo do të vish?

Tjetri i hodhi një vështrim me habi e kuresh-tje, përzier bashkë, dhe, ngaqë u gjend në befasi, bëri atë pyetjen e zakonshme e fare pa kuptim.

— A keni vend?

Shoferi jepte shenja me të dyja duart që nga kabina e lartë e «skodës»: «Hajde, hajde brenda, ç'pret akoma?» Aviatori i ri u çapit me rrëmbim, duke futur nën sjetull çantën e vogël ngjyrë kaki dhe, sapo u gjend tek dera e hapur e kabinës, përshëndeti e falënderoi ata që e thirrën. Ai u ul me kujdes prapa njeriut që e kishte thirrur me zërin e çjerrë. Ky ktheu dy a tri herë kokën mënjanë, hodhi ca vështrime prapa me bishtin e syrit dhe u duk sikur bëri buzën në gaz me udhëtarin e ri. Ndërkohë shoferi me pakëz kolpo ndërroi marshet e i dha udhë maqinës. Kaluan ndoshta dhjetë minuta që kur se hyri në kabinë udhëtari i ri ushtarak. Atë po e mbulonin gjithfarë mendimesh. Më tepër se çdo gjë e mundonte heshtja, që gjeti aty brenda largimi i bisedës, që i dukej se qe dëbuar prej tij. Burri me zërin e çjerrë, ndoshta për forcë zakoni, bënte po atë punë; pas çdo minute rrotullonte kokën nga dera. Ngjyra e kaltër e syrit ngecte paksa mu në kend të kapakëve dhe më pas ai profil me tipare të theksuara, mbulohej nga ca flokë të thinjur.

Shoferi zgjati paqetën pa hequr kujdesin nga timoni. Udhëtari i ri nuk e mori cigaren, por falënderoi përzemërsisht. Ai e ndezi për vete dhe, duke lëshuar një shtullungë tymi, që qëndroi si re në kabinë tha:

— Po ti, more shok, pse nuk nxore një llaf. Qenke nga tipat e librave ti, që thonë se i deh udhëtimi, apo mos ke lënë kalamajtë pa bukë në shtëpi e të bren meraku. Një gjë do të kesh ti që s'përgjigjesh në muhabet. Nga të kemi ty? Po ku shërben? Po tifoz të kemi, apo jo? Na u mund «Patizani»...

Ai heshti një copë herë, pastaj shtoi:

— Jam bërë llafazan, dreqi e mori. S'kam qenë kështu, jo! Duket se po më vjen fundi dhe ma kënda të zbrazem. . .

Pastaj e zuri fort timonin me të dyja duart, sikur desh ta ngrinte fluturimthi maqinën.

Burri me zë të çjerrë që rrinte përpara, ktheu kokën nga dera si zakonisht, shikoi me bisht të syrit dhe prapë buzëqeshi. Këtë radhë qëndroi më shumë ashtu dhe u dëgjua zëri i tij. Një zë i rëndë përzier me shumë zhurma.

— Isha në aerodrom. U takova me gardën e vjetër dhe bëra një bisedë me të rinjtë. . . Ju pashë edhe ju bri një aeroplani transporti. . . Bije shumë në sy transportuesi në mes gjuejtësve. . . edhe piloti i transportit. — tha ai që rrinte përpara, dhe i shkujdesur mori në duar atë çantën e aviatorit të ri, që e kishte lënë mbi motor. E shikoi me kujdes shlemofonin aty brenda dhe e la në vend.

Udhëtari i ri ngeli për ca kohë i habitur, duke shtypur me dorë sedilen ku rrinte. Dëgjonte përherë dhe veshët i mbufateshin. Zëri i ngjirur, tiparet e theksuara të fytyrës, ajo shprehja «gardë e vjetër» të bënte të mendoje se ky duhej të ishte ai, aviatori Sulo.

Tek e shikonte, s'ja merrte mendja që ky burrë me tipare të rregullta të fytyrës, ky njeri shpatullgjerë, leshrathinjur, ende të dendura si shtëllunga, të kishte një moshë rreth të dyzetave, me barrën e rëndë të luftës e të viteve të shkuara të pasluftës. Ky të ishte vallë ai Sulo, që u ngjit pas brigadës partizane dhe nuk u nda prej saj me gjithë këshillat, urdhërat e më në fund nuk ju tremb as kërcë-

nimeve për t'u kthyer në fshat, se qe shumë i vogël? Qysh në përpjekjen e parë ju dha rasti të rrëmbente një belxhik e me të rrëshqiti gjer në Vishegrad. Zëri ju mor e ju bë i çjerrë së thirruri «Përpara», gishti i këmbëzës i zuri kallo. Për trimëritë që tregoi në luftë, një nga udhëheqësit e shtetit e përmendi në kujtimet e veta. Ishte ky shok që, menjëherë pas çlirimit «i dha urdhër» të bëhej pilot. Djaloshi që mbante në brez dy «breda», dy gjerdanë me fishekë, një nagant e një dyfek në krah e kishte parë me habi dhe qe shprehur:

— Unë pilot? Jo, or shoku komisar, jo...

Komisari kishte vërejtur se atë kohë diçka po ziente në kokën e djaloshit me vetulla të ngrysura, me sytë përdhe.

— Ç'pate kështu? — i pat thënë duke e kapur fort për balukesh, që i dilnin përposh kapës me yll e i binin mbi ballin e shogët nga erërat e malit.

Partizani e kishte mbajtur gjer në fund kokën ulur, i vendosur që edhe sikur baluket të mbeteshin në grushtin e komisarit, ai s'do ta bënte përpjetë kokën.

— Kokëshkëmb! Ç'pate kështu si mushka? Ç'të erdh e të pushtoi ky rrebesh pranvere?!...

— Unë s'jam doç, që të bëhem pilot... — shpërtheu tjetri. — Unë vërtet nuk i kam prindët, por s'jam... që të bëhem pilot, shoku komisar...

Kështu i qe zbrazur ai komisarit të brigadës, se i kishte rënë në vesh, që asokohe në një qeveri «andej nga Evropa mbledhin poshtë e përpjetë doçërit dhe i vënë në aeroplanë të luftojnë». S'do mend, kjo ishte një çikë për të qeshur, por komisar i s'e bëri veten fare; ai u vrejti e më në fund «dha

urdhër». Urdhëri për partizanin u bë ligj. Ky ishte «çarmatosur». Natyrisht, brenga e ndarjes nga gjerdanët dhe nga belxhiku do ta ndiqte pas kudo që të ndodhej.

«Le që më futën në një takëm me doçat, po më hoqën edhe pushkën. Ku është këtu liria e fjalës, xhanëm?»

«Jetoka aviatori Sulo! Sa kemi dëgjuar për të dhe s'na ka vajtur në mendje të pyesim ku ndodhet, gjallë a vdekur është» — tha me vete aviatori i ri tek rrinte i humbur në mendime atje në sedilen e pasme.

Të tëra ç'thuhen për aviatorin Sulo janë bërë të vërteta dhe nuk të rëndohet sikur t'i dëgjosh dhjetëra herë, siç u ndodh aviatorëve të rinj. Edhe ai ka qenë dikur fare i ri dhe ka pasur një ëndërr në jetë, një ëndërr të madhe...

Mbrojtja e atdheut këtej e tutje për aviatorin mbetet si për çdo ushtar një detyrë e shenjtë, por ajo merrte trajta të reja në mendjen e tij mbushur me imagjinatë djaloshare: ai do të bënte roje fluturimthi, përmbi shkrepë, e do të vëzhgonte së a-ndejmi horizontet e Republikës, si ç'bën shqiponja në follenë e saj. Ai kishte për të zënë «pusi» atje në hapësirë — ja për se pati mësuar në atë shkollë tre vjet me radhë — e do të përgjonte me sy në she-njestër e me gisht në «këmbëz».

— Çfarë pushke mban ky aeroplani? — kishte pyetur Suloja sapo vuri këmbën në shkollë, dhe i kishte ardhur çudi që aeroplanët rrinin nëpër hangare të mëdhenj. Atij i qenë dukur ata njësoj si mushkat e murme nëpër stalla, që dremitin në këmbë. Ndërkohë, mu aty në mes aeroplanëve,

Sulos i shpjeguan se këtu nuk mbahet pushkë e kobure dhe as që bëhet fjalë për ato. Aty vendosen mitralozë, topa të lehtë e bomba dhe bëhen përpjekje që të vihen edhe raketa. Ai i kontrolloi me sytë e vet e i preku me dorë dhe ndjeu kënaqësi, sido që ju thye pak zemra, që shkrepja nuk bëhej me këmbëz, po me buton.

— Mirë, o mirë, po syri ku shënon këtu?

— Këtu ka një shenjstër automatike dhe nuk mbyllet asnjëri sy.

— E, he, qenka me elektrik kjo punë, — ja kishte pritur Suloja duke rrudhur buzët, sikur donte të thoshte: «Mori fund gishti i pushkës dhe syri i pushkës»

Maqina herë troshiste dhe kokat e atyre që rrinin në kabinë shkonin përpjetë, herë rrëshqiste shtruar dhe atyre sikur u vinte ajo përgjumja e zakonshme. Vetëm shoferi, që i trembej kësaj dremitje, me vend e pa vend u qahej udhëtarëve...

— Po më vjen fundi... Jam bërë llafazan... merrem me thashetheme rrugësh...

Ata të dy nuk po ja vinin veshin, sepse secili, që kur këmbyen bisedën e parë, ishte kredhur në mendimet e veta. Lulet e bajameve që shfaqeshin aty-këtu ndanë xhadesë, thuajse fshiknin xhamet e kabinës. Ato dridheshin në athëtimën e asaj dite dhe i ngjallnin cilitdo një ndjenjë dëshpërimi, që kishte të bënte me atë pafuqinë e njeriut ndaj vrazhdësisë së natyrës: ajo me një dorë jep, me tjetrën merr.

Ai udhëtari që rrinte përpara dhe që tani besohej nga tjetri se duhej të ishte aviatori Sulo, si ktheu kushedi për të satën herë kokën nga xhami

i derës, qëndroi ashtu dhe me zërin e ngjirur pyeti:

— Ti në çfarë fluturon?

Aviatori i ri u zgjat përpara, qëndroi ca në mëdyshje, pastaj me gjysmë zëri tha:

— Siç e patë, unë prura në atë aerodrom një aeroplan transporti.

Nga gryka e tjetrit u rrukullisën nja dy fjalë të ngjirura, që u shuan fare nga zhurma e motorit. Ato lanë në këndet e buzëve të tij një lloj trishtimi të largët. Aviatori i ri përpiqej të kapte ato dy fjalë që u thanë aq ulët nga ai zë i ngjirur e si i çjerë. Tek vërente me kujdes tiparet e atij profili shumë të ngjashme me ato që thuheshin për aviatorin Sulo, ju bë se ato dy fjalë të pakapshme duhej të qenë «Pa armë»...

Thoshin se aviatorin Sulo nuk e zinte gjumi as ditë as natë për të bërë realitet një ëndërr të tijën. Asokohe, pas afro tre vjetësh studimi, ai u kthye në kryeqytet si aviatori i parë shqiptar, me ëndërrën e madhe në gji e me një mori tjetër ëndërrash të vogla. Ajo e madhja ja brente shpirtin, pa me të tjerat ndreqej.

«Do të presësh ca, o Sulo, — i patën thënë eprorët, — së shpejti vijnë aeroplanë që fluturojnë si era, e të bukur si sorkadhe mali. Ke për të parë...»

Ai i kishte vështruar drejt në sy eprorët dhe qe çuditur se si këta ditkan më shumë nga sa dinte ai vetë tre vjet të shkuara. «Kanë kryer të gjithë shkolla, akademira» mendoj, e sido që të ishte, dëshira e shtynte që t'u thoshte:

«Dre, dre! Paski parë aeroplanë të shpejtë si era, të bukur si sorkadhe?! E ditki ju që shpejtësinë e lakmon piloti! Dre, dre!»

Që kur se u ul në bangat e asaj shkolle që të «peshonte» e të «matte» për muaj, ku të bënin një-mijë e një «pelivanllëqe», ai me disa shokë përbënte një palë, që kundërshtonte palën e atyre aviatorëve që linin mentë pas shpejtësisë. Shpejtësitë e mëdha, ishin gjithshka për ta, pala tjetër, me aviatorin Sulo, s'hiqte dorë nga armët e fuqishme. Doemos, kur punët merrnin flakë, në mes të dy palëve qëndronte pedagogu, që lidhte me mjeshtëri shpejtësinë e madhe me forcën e zjarrit. Pastaj fjalët e tij merrnin rrjedhë të pandalshme dhe formula dilte kështu: në krye njeriu, pastaj manovra e forca e zjarrit... Në këto raste, pala e aviatorit Sulo, kthente kokën mënjane nga dritaret dhe rrinte ashtu një copë herë të gjatë.

Nesje, për shkollën shumë gjëra thuheshin, nga ato më të rëndomtë e deri te më interesantet.

— E, kur do të vijë ata aeroplanë? — kishte pyetur një herë tjetër Suloja me shpresa të paka.

—Së shpejti vijë... .

Kjo përgjegje, që përsëritej vazhdimisht e brengoste sa më s'bëhet djaloshin e ri, se ishte i etur të bënte «roje» atje, në hapsirë. Kështu që ditë me radhë nuk i zunë këmbët dhe, mirëpo, prapëseprapë, s'merrte vesh në qëndronte në tokë apo në qiell. Rrahu dynjanë gjersa i zuri veshi një propozim të çuditshëm. «Ka ca aeroplanë atje, në një qoshe të aeroportit, po ta mban hipju!»

Tregojnë se këta qenë ca tipa aeroplanësh të fillimit të Luftës së dytë botërore të zënë trofe. Sidoqë ishin të vjetër e të panjohur nga ana teorike, aviatori Sulo i dha karar se mund të ngrihej në qiell me ta. Tek e fundit, çdo gjë që të ndodhte,

ai do ta linte të shkonte në djall atë maqinë fashiste e do të hidhej me parashutë. Në krye të javës, një prej atyre aeroplanëve të shushatur, që nuk priste askend t'i hipte kaluar, zhzhuriu në ajër ashtu zemrak e kryeneç, me sa duket ngaqë kishte këmbyer të zotin, pastaj zbriti në aerodrom i nënshtruar plotësisht.

Mirëpo Suloja na kishte dalë nga kabina i ngrysur e pa qejf. Megjithëse kur punët nuk i shkonin aq mbarë, ai dinte të mbahej përbukuri, këtë radhë, edhe pse përpiquej, dukej faqeza se vuante përbrenda.

Ç'e shqetësonte në shpirt pilotin?

Shokët, tek e prisnin me ankth, i patën hedhur ato vështrime hetuese, që janë të zakonshme pas fluturimit, por nuk mundën t'ja njihnin brengën që e mundonte.

— Ne këtej nga poshtë as pamë, as dëgjuam ndonjë gjë të dyshimtë... Ti e pilotove përbukuri këtë maqinë të lënë nga okupatori rrugëve... Kjo do të na shërbejë për ca kohë...

Piloti, pasi kishte zbritur, ishte hequr mënjanë si ndonja dhjetë metra në brinjë të aeroplanit, që dukej si një kalë i djersitur nga një vrap i çmendur, e me sytë mbërthyer diku, pranë kabinës, tundte kokën pa thënë asnjë fjalë.

Ata që s'dinin ende ku e si qëndronte puna, thanë:

— Do t'ja heqim atë biçim kryqi, që ngjan si oktapodh e do t'i vëmë flamurin tonë në trup, në krah e në bisht... Ke për të parë si do të zbukurohet...

Një copë herë të gjatë nuk ju nda nga sytë ajo

pjesë e kabinës në të djathtë, pakëz prapa. Pastaj vështrimi i rrëshqiti larg, nëpër hapësirën e aerodromit, duke përfshirë majat e maleve me dëborën që vezullonte. Era që zbriste prej andej, i binte në fytyrën e menduar e me bula djerse.


— Pa armë nuk ja vlen një grosh kjo punë. Duhet t'i bëjmë derman... — kishte thënë ai më në fund, me zë të fortë e të ngjirur, duke lëvizur me kuptim atë gishtin e këmbëzës.

Era që frynte nga malet, sikur e shpuri ngado shqetësimin e aviatorit Sulo. Në krye të muajit, në aerodromin ku ai shërbente, erdhi një letër e mbyllur me zarf e me vulë zyrtare. Atij s'i vinte të besonte që ish komisar partizan t'i dërgonte adresë të saktë ku mund të gjendej një mitraloz aviacioni. Madje kishte vënë buzën në gaz tek lexonte ato radhë, që i sillnin në mend ndarjen nga brigada.

Kësisoj ëndërra e aviatorit po plotësohej. Ai për së shpejti do të fluturonte me një aeroplan të armatosur.

Siç dëgjohet nga goja e disa prej specialistëve të armatimit, thonë se Suloja vetë e pati dhënë mendimin që sistemi i shkrepjes, po të qe e mundur, të bëhej me buton. Ata e njihnin mirë shokun e tyre dhe kishin qeshur. Por, ndërkaq, mitralozi u vu atje pranë kabinës, në bordin e djathtë, me tytën pakëz lart e paksa të dalë jashtë. Në fluturim e sipër, pilotit ju bë zakon që të kthente kokën djathtas për të parë atë copëz tytë. Gëzimet e Sulos, të mërguara qysh kur dorëzoi belxhikun, ja behën së rishmi dhe e pushtuan të tërin. Tani ai kishte me se të bënte roje në qiell.

... Pas një ore udhëtimi, maqina e preu zry-



Èndra e aviatorit Sulo

shin në stacionin e trenit. Motori dha e mori dy tri herë me gulçima, pastaj e shtoi zhurmën. Ai që duhej të ishte aviatori Sulo, pa e bërë të gjatë u përshëndet me ata që do të vazhdonin të iknin tutje, hapi derën dhe sakaq u gjend jashtë kabinës. Ai u zhyt në turmën e urdhëtarëve që endeshin kot më kot nëpër shesh, duke shtyrë minutat e fundit të pritjes. Maqina mori të ikte përpara, por një skuadër fëmijësh të shkujdesur, që mbanin në krah ca shkopinj të sajuar si pushkë, e bënë të presë hovin.

Aviatori i ri, sikur të ishte përmendur nga një ëndërr, u çua përgjysmë në sedile dhe nxori kokën nga xhami i hapur. Në këto çaste ishte mjaft i penduar që nuk e pyeti atë njeri, në ishte me të vërtetë aviatori Sulo. Por në fund të fundit ç'rëndësi kishte kjo, kur gjithësa thuheshin për atë ëndërrën e tij qenë të vërteta.

AEROPLANI DHE BRIGADIERJA

Atë kohë që u duk aeroplani në qiell, punëtorët e fermës ishin në pushimin e drekës. Ai kaloi fluturimthi mbi ato vende dhe iku për t'u ulur në fushë. Ata të sektorit të vreshtave qenë entuziazmuar aq shumë, saqë në çast e me një frymë u gjendën atje dhe uronin pilotët: «Mirse erdhët, mirse erdhët».

Domosdo, nuk ishte e pakët që të spërkateshin, vreshtat në një kohë optimale, kur dyshohej për shfaqjen e insekteve të dëmshme. Dhe pa dyshim, kuptohet fare mirë se përse të gjithë u ngritën më këmbë dhe e mbajtën frymën andej nga aerodromi. Askush nuk i kishte urdhëruar punonjësit që të ndihmonin sikush më shumë për të nxjerrë thasët me zineb nga depua, për të ngarkuar e për të shkaruar rimorkion e zëtorit. Pastaj, duke rrëmbyer nga një thes, të suleshin tutje dhe t'i çonin mu tek aeroplani, që mbante era herbicid. Tërë ato lëvizje shko e hajde të njerëzve, që mbanin nga një thes zineb, përngjanin me një aksion masiv me goditje

të përqëndruar, në të cilin merrnin pjesë edhe punonjësit e administratës. Në mes të turmës shquante për së largu një i ri ca i çuditshëm, që e thërrisnin me një nofkë po aq të çuditshme «Ariu». Mungonte aty shefi i planit, që doemos vonohej vetëm për «arësye të forta...» Mirëpo s'kaloi shumë dhe njerëzit u rralluan fët e fët. Me sa duket, secili zuri vendin e vet pa zhurmë e pa bujë. Ndoshta gjithshka që ndodhi i përkiste vetëm asaj pritjes së zakonshme simbolike. Njerëzia qenë larguar, vendin e asaj turme të potershme e zunë punëtorët dhe brigadierja e re e sektorit.

Aviatorët e ndjenë veten të shurdhër. Pas atyre tre mbushjeve, që nuk zgjatën më shumë sesa të pije një cigare duhan, atyre ju duk sikur puna ngeci si një ingranazh me dhëmbë të thyer, ndërsa motori i kohës punonte ritmikisht. Skapamentua rrihte ajrin, si të ishte një sekondmatës. Edhe brigadieses së re, me sa duket, zuri t'i rrihte në kokë skapamentua e kohës: pam, pam, pam... Dielli po varej në perëndim, duke hedhur mbi horizont një tis të përskuqur, që sa vinte bëhej më i ndezur. Brigadierja vërente dëndur orën, u thoshte diçka punëtorëve dhe së bashku me ta jepte e merrte për të mbushur aeroplanin me zineb e pluhur squfuri.

«Këtej e tutje, vartësia jonë kalon tek një vajzë e re», — menduan aviatorët.

Shefat qenë larguar.

— Sidoqoftë u tregua e fortë.

— Gratë s'para i zë aeroplani, ato vetëm se kanë frikë të fluturojnë.

— Mendon se tek burrat nuk ekziston ajo frikë?

— Jo në atë shkallë, si tek gratë.

— Je gabim, burrat dinë të hiqen, ndërsa ato shfaqen me tërë ndjesitë...

— Ndoshta ke të drejtë.

— Sido që të jetë, u tregua burrneshë.

Piloti tjetër qeshi.

— Kjo është fjalë me vend.

Aviatorët u endën një copë herë nëpër aerodromin fushor, duke biseduar për gjëra pa rëndësi, për historikun e ngritjes së asaj ferme dhe agromomin e parë, për rrushin që rritej aty, si dhe për natyrën e bukur të atij vendi rrëzë maleve me shkrepë të ashpër, buzë liqenit të kaltër. Pas pak, si panë se qenë larguar kot së koti nga aeroplani, ata u kthyen. Për së largu hodhën sytë andej nga punëtorët, ku vunë re se kishte ardhur ai djaloshi interesant me atë nofkën e çuditshme «Ariu». Brigadierja e re dukej se kishte marrë një pozë lodhjeje, pështetur në krahun e aeroplanit. «U lodh, femër është», mendoi njëri nga aviatorët. Ata ishin afruar heshtazi mu aty pranë. Thasët me zineb thuase fluturonin nga toka përmbi aeroplan, ku një punëtor, me hundët e fshehura nën një maskë bërë me fash, i zbrazte në depozitë. Ai, djaloshi, që sapo nisi nga puna, i rrëmbente thasët nga vendi i grumbullimit, ndonja njëzet metra larg, dhe me një frymë ja çonte në dorë tjetrit. Dukej sikur kish-te marrë një yrysh të papërmbajtur për të bërë këtë punë ec e jak brenda atyre njëzet metrave. Në ato caste, për të nuk ekzistonte gjë tjetër, veç atyre thasëve, që duheshin lëvizur. Supet e hajthme qenë lagur nga djersa. Dhe, ndërsa krahët e hollë shtrëngonin thesin e hedhur në sup, këmbët e gja-

ta, nën pantallonat me gjunjë të dalë, lëviznin mekanikisht e shatra-patra. Ato këmbë, me ca këpucë të lehta e të mëdha, dukej sikur mënt do të ngatërroheshin, madje trupi i djalit lëkundej si një kallam i gjatë nga era e fortë.


Cilitdo që ishte aty pranë, natyrisht veç punëtorëve dhe brigadieres, do t'i krijohej bindja se ky djalë ishte një nga ata komikët e rëndomtë, që takohen jo rrallë në jetë e që i vënë qëllim vetes të bëjnë punën dhe, njëkohësisht, të zbavitin sado-pak të tjerët.

Aviatorëve kjo u shkoi në mendje sapo e panë aty. Pastaj menduan se ndoshta ky djalë që nga ata simpatizantët e shumtë të aviacionit, që janë gati t'i shërbejnë aeroplanit dhe aviatorëve për një fluturim të dëshiruar pa masë.

Mirëpo ai nuk jepte asnjë shenjë për këto. Aviatorët pikasën se ai vështronte dendur brigadieren, që rrinte shkujdesur pranë krahut të aeroplanit. Ajo kishte nxjerrë një blok dhe diçka po shkruante, e përkulur pa kujdes. Kur ngriti kokën, ai e vështroi me mënyrën e tij, duke rrudhur vetullat e holla përmbi sytë e përhimtë:

«Rri aty, se e mbaruam punën», dhe u hodh me turr tek thasët e fundit.

Aviatorët, që gjer atë çast patën menduar ndryshe për atë djalë të ri, të dobët, të hollë e të gjatë, me supet e hajthme të qullura nga djersa, nisën të shikonin me habi njëri-tjetrin. Ishte e vërtetë që ai kishte ngjallur qysh në fillim te këta një farë interesi me ato gjeste komike dhe me atë nofkë jo më pak qesharake «Ariu»? «Nuk punoka për të «hipur» në aeroplan ky», kishin menduar dy shokët



Aeroplani dhe brigadieri

aviatorë, sapo panë që djali i ri e vështronte brigadierin në një mënyrë, që ngjallte dyshime.

Me sa dukej dhe ai pikasi diçka tek aviatorët, që rrinin tutje krahut, në hijen që lëshonte krahu. Dhe sakaq, duke e shtyrë shikimin nga brigadierja e re, i ndali sytë rrëshqanthi tek ata, sikur donte të thoshte «emancipimi e kërkon...» Dhe ata sa nuk ja dhanë gazit.

Ai rrëmbente thasët e fundit. E bënte me aq ngut këtë punë, saqë dukej sikur do t'i ngatërrohe-shin këmbët e do të rrëzohej. Brigadierja e re qesh-te me nxitimin e tij.

Po qe se nuk do të kishte ndodhur diçka e papritur, aviatorët as që do të mësonin gjë dhe, në fund të fundit, do të gjykonin për atë njeri sipas hamendjeve të tyre dhe me siguri kishin për të thënë: «Sa njeri i çuditshëm, ë?»

— Ka të ngjarë ta ketë diçka ky, — tha njëri nga pilotët me zë të ulët.

— Cilin të ketë? — pyeti tjetri.

— Atë, brigadierin.

— Ku ta dish. Ndoshta e ka...

— Nuk e pe si ja bëri me shenjë?

— T'i lëmë këto «thashetheme»; më mirë do të jetë të ngremë edhe ne nga një thes për emancipimin...

Atë kohë matanë u dëgjua një skapamento, që punonte me rrahje të ndërprera dhe dëgjohej si e lehura e një langoi të largët. Në rrugën përgjatë vreshtës pa anë, u shfaq një njeri mbi një motor, që brëndhte drejt aerodromit. Një fashë pluhuri zgjatej për një çast dhe sakaq humbiste përmbi vreshta.

Vetëm një motor rrihte kështu me ndërprerje, dhe vetëm një njeri e lëshonte udhëve të fermës duke mbytur botën me pluhur. Dhe të gjithë e dinin se ai nuk e lëshonte lehtë nga duart, se i dhi mbsej «prona e përbashkët». «Motori është i të gjithëve, ndaj edhe unë e ruaj si sytë e ballit. Nuk e lëshoj azat, se është pasuri e përbashkët e popullit». Kështu, ai mbante një leksion të tërë po qe se ndonjë punonjës ja lypte për punët e fermës «Javën» e dhemshur.

— Shefi, — tha brigadierja.

— Shefi?! — tha «Ariu».

Kështu, pas një minute, në aerodrom ja behu shefi i planit, një njeri që, siç thoshin, nuk i qeshte buza, veçse kur zihej dielli.

Sapo e pa aty pranë, «Ariu» rrudhi vetullat e u vrejt, gjë që e bënte më komik se ç'ishte në të vërtetë. I hodhi sytë brigadieses me një vështrim të vendosur, sikur donte t'i thonte «Mos ki gajle» dhe iku për nga aeroplani, duke kthyer shpatullat e hajthme, mbuluar gjithë djersë.

— Si ngaherë po tregohej jashtë mase i zellshëm për të ndihmuar gratë... — tha shefi si me vete.

Brigadierja lëvizi vendit, duke ju afruar më pranë togut me thasë.

Një harabel që kruante sqepin atje lart, tek bishti i aeroplanit, e ndaloi këtë punë dhe bëri kokën mënjanë, për të parë më mirë se ç'po ndodhte atje poshtë.

— More djalë, ku je ti këtu? Lë detyrën që ke, dhe vjen e mbush aeroplanin. More, po ç'i thonë

kësaj?! Pse bëni kështu në orarin e punës? Dhe pastaj thoni pse thërresin ata të administratës.

Deri këtu dukej se shefi kishte shumë të drejtë.

— Përse e bëni këtë marifet, xhanëm? — e pyeti atë që ngrinte thasët, dhe vërviti krahët lart. — Kush flet këtu?

«Ariu» nuk nxirrte zë, si të qe shurdhuar. Diçka që kishte ngjarë jo shumë kohë përpara, e bënte të kridhej në mendimet e veta: «Mos u dorëzo. Lufto...».

— Brigada e ka mbaruar punën, shoku shef, — i tha vajza, — dhe «Ariu» qëndroi me dëshirën e vet... .

Ai zuri të baresë kot së koti.

— Nuk qenkeni hiç shpirtgjerë, — tha jo pa qëllim një nga pilotët.

— O, më falni! Keni të drejtë, po... duhej t'ju kisha thënë së pari mirëseardhjen... doemos, po... më bezdisin, më bezdisin. Kërkohet organizim... e kisha planifikuar të vija një herë këtej nga aeroplani... .

Fliste paprerë, ndërsa i jepte fytyrës herë një shprehje të dhemshur, herë të qeshur, herë serioze.

Siç u muar vesh më vonë, nuk kishte qenë e lehtë që vajza të bëhej brigadiere. Një nga kundërshtarët më të fortë paskësh qenë shefi, ndërsa një nga përkrahësit, «Ariu» i imët, që punonte me zell nën atë vështrim të kaltër.

Kur mori fund mbushja e aeroplanit me zineb, brigadierja hyri në kabinë bashkë me aviatorët, kurse «Ariu», që rrinte jashtë, buzëqeshte pak hidhur, sikur donte të thoshte: «Natyrisht, nuk duhet dorëzuar...».

Ndoshta i vinte një çikëz keq që për disa çaste do të rrinte vetëm, me sytë nga qielli, derisa të shihte siluetën e aeroplanit që do të ulej në aerodrom. Pastaj do të hapej dera e do të dilte brigadierja.

PËRMES VËRSHIMESH

Fshati H dikur ka qenë më i përmenduri në rreth. Ai u bë i pari kooperativë dhe nisi mbarë jetën kolektive. Punonin që të gjithë mirë. Të ardhurat qenë të bollshme. U ndërtua një shkollë, një vatër kulture dhe një kinema. Dhe një central për dritë elektrike. Ata të komitetit të partisë, në raste festash, dërgonin përherë fletëlavdërime dhe s'kishte gazetar që të vinte në rreth e të mos kthehej në fshatin H. Kishin hak. Fshati kish ndryshuar. Edhe njerëzit patën ndryshuar mjaft. Të rinjtë ngazëlleheshin, ndërsa të moshuarit sikur përtëriheshin.

Vajzat e reja me faqe e llërë të përzhitura nga dielli arave, mbanin veshje me ngjyra të ndezura, që dukej se shfaqnin para kujtdo shpirtin dhe temperamentin e tyre të gjallë. Kur mbrëmja mundohej të venitte ngjyrat, çupat tufa-tufa ngjiteshin për nga vatra e kulturës dhe shpërthenin në këngë. Ata zëra që plekseshin nëpër terrin e mbrëmjes, krijonin ca tinguj që u silleshin të tërëve për-

qark dhe, tek i dëgjonin, ndjenin gudulisje mu në gjoks.

Djemtë, të krehur e të pispillosur u vinin vërdallë çupave dhe më të rrallë u hidhnin nonjë romuz me kripë.

Pleqtë ndjenin kënaqësi tek shikonin çupërinë dhe djemurinë e fshatit dhe rrëkëllenin ndonjë gotë andej nga klubi. Ata conin në mendje kohët e shkuara dhe thoshin përherë: «Ah, djalëri! Që na shkove fët e fët...»

Që kur se nisi jeta kolektive u duk se të gjithë përqafuan çdo gjë të re. Dhe kështu ngjante sikur edhe pleqtë, që merreshin me ndonjë punë të lehtë, qenë bërë njësh me të rinjtë. Kjo ndoshta vinte ngaqë jeta e re i përngjante një vërshimi dhe vërshimet nuk pyesin për çka gjejnë përpara: i luajnë nga vendi, i shkundin, i çojnë tutje.

Mirëpo, në mes atij vërshimi, kishte mundur të mbahej në rrënjët e tij një dru i vjetër... Xha Malua, me lëmushqet e kohës, që i rrinin mbi kurizin e dalë.

Xha Malon, ndoshta më të moshuarin në fshat, e shikonin të gjithë si një copë kujtim nga e kaluara dhe u dhimbsej sa më s'bëhet. Farë e fisi i tij thuajse qe shuar i tëri nga lufta dhe nga sëmundjet e uria, që asokohe bënin kërdinë, sikur të qe një rrebesh i çmendur. Kaluan pastaj disa vjet dhe ngjau ajo më e madhja: xha Malua ngeli fill i vetëm me mbesën pesëvjeçare. I biri ushtar u vra në kufi.

«Edhe kjo i lipsej», — thoshin fshatarët —. Kjo do ta luaj nga fiqiri fare, xha Malon e shkretë. E, që të mos ngjante kështu, ju gjendën pranë që nga kryesia e gjer tek organizata e rinisë. Prapë

jeta zuri rrjedhën e saj në shtëpinë e vjetër të xha Malos. Pak nga pak u tret edhe ajo perde pikëllimi e zyrtësie që ndehet mbi fytyrën e plakut. Ai zuri të shfaqet poshtë e përpjetë udhëve të fshatit me mbesën për dore. Të gjithëve u bëhej qejfi tek e shikonin.

Ditët kalonin. Xha Malua zbriste pa zbardhur në fushë me Vjollcën për dore dhe ngjitej mbrëmjeve për në shtëpinë e moçme, me strehë të dala e të epura vende-vende. Në fillim xha Malua e merrte mbesën për t'i mësuar duajt, çezmat, dyqanet, mëhallat dhe arat e kooperativës. Këtë e dinin të gjithë dhe e shikonin me sytë e tyre. Por, më pas çupa u rrit pa u vënë re. Ajo hodhi shtat e lulëzoi, tamam si një manushaqe që bën mënjanë nga ndonjë trung i moçëm me lëmyshk dhe kërkon rrezet e diellit. Po aë se gjen rrezet e parë, ajo gjallërohet e merr fuqi, për të bërë më lart.

«Hodhi rrënjë e degë të reja jeta në shtëpinë e xha Malos» gëzonin të tërë dhe shtonin se s'kishte si të ndodhte ndryshe. Ndërkaq mbesa zuri të hiqte për dore poshtë e përpjetë gjyshin xha Malo.

Pleqtë e moçëm, duke rrëkëlyer ndonjë gotë atje në klub, ndjenin kënaqësi kur shikonin Vjollcën tek hiqte nga dora gjyshin. . .

— Mirëmbërëma, xha Malo! Si u erre? — e pyesnin. Kurse gjyshi shurdhak e dritëshkurtër çapitej si një hije e heshtur përbri tyre dhe ata dëgjonin t'u përgjigjej e mbesa, me një zë që mezi kapej:

— Mirë, si u ngrysët ju? — dhe thoshin: «Eh, plakush! Pate fat që rrite një vajzë të tillë!»

Të rinjtë zunë të brehen nga meraku. Gjer atë kohë Vjollca qe rritur nën hijen e një çatie të vjetëruar. Ata e dinin mirë se, që të heqësh një lule e t'i ndrosh vend duhet marrë me gjithë rrënjë. Dhe duhet ta ujitësh e ta kesh kujdes.

Rinia nisi të mendojë. Si bëhej më mirë? Të ngarkojmë nja dy shokë e shoqe të punojnë me të? Ta thërresim në mbrëmje më dendur? Ta fusim në valle? Ta çojnë në festivalin e grupeve artistike?

Plaku, sapo i shkonin në vesh këto, ndjente sëmbim. Tundte kokën e mjegulluar nga thinjat e shumta, duke u përpjekur të rrinte i qetë, dhe mendonte: «Do të mësojë çupa prapësitë e dynjasë...»

Ndërsa jashtë kokës së tij mbillte fjalë, që ndillnin trishtim e dhemshuri.

— Kush do më bëjë hyzmet mua? Unë s'jam për gjë... Ja, sa të vdes, të qërohem nga kjo dynja, pastaj...

Njerëzit zunë të lëkunden e të ndahen në dy pjesë. Disave u vinte keq për çupën, të tjerëve u dhimbsej plaku. Si të bënin? «Epo mirë?!... Epo ç'ka!... Hëm çupa, hëm plaku...» — thoshin poshtë e përpjetë ata, duke i lënë mendimet në mes të rrugës.

Kështu xha Malua kapërcente hendeqe në vjeshtën e prasme të jetës së tij. Kur papritur në fshat muarën dhenë fjalët «aksion», «hekurudhë», «vullnetarë». Rinia brofi në këmbë:

Aksioni ynë... ç'presim?!... Kemi qenë kurdoherë të parët...»

U bënë fët e fët listat. Gjithë rinia ishte gati. Po Vjollca? Si qe puna me të?..

«Punë e madhe! Një është ajo... Pastaj, xha Malua...» — ja bënin disa.

«Hajde mendje, hajde! Hekurudha edhe pa Vjollcën s'do jesi, po Vjollca ç'do bëhet...» — kundërshtonin të tjerë.

«Eh, ç'kemi bërë ne!... Harruam ne...»

Xha Malua me të mbesën i rralluan thuajse fare daljet në udhët e fshatit, sidomos aty nga qendra as që dukeshin. Për të shkuar në arë apo gjëkundi tjetër i binin përçark, shteg më shteg, andej nga kalonte vija e ujit. Ata që i shihnin, thoshin se qenë shumë të zymtë si plaku që i hidhte këmbët kuturu, si e mbesa, që shkelte lehtë e ngjante sikur fluturonte ledheve.

Që kur se u dëgjua në fshat fjala «aksion», xha Malua u pushtua nga ca ethe, që s'i kishte provuar kurrë. Sikur i derdhnin në kurriz gjyma me ujë të ftohtë. Një javë të tërë i ranë këmbët duke bredhur qosheve të errëta. Endej nëpër fusha si hije dhe mblihte përçark vetes ca koka, që u thoshte fshehurazi gjysmën e së vërtetës, ndoshta një çikë më pak:

«Atë kam shpresë në jetë... Të ikë ajo, është njësoj si të vdes për së gjalli...» Dhe i bëhej zemra mal, që kishte gjetur fjalë me vend për t'u kthyer mendjen njerëzve, që po e mëshironin. Ndërsa të fshehtë, atë të keqen e madhe që e brente përbrenda si krimbi që i ka hyrë drurit mu në palcë, ai s'ja kishte shfaqur ndonjërit dhe ndoshta asnjëri nuk do ta mernte vesh. Aq mend i kishin mbetur xha Malos... «Nuk ja del mbanë njeriu duke rrëfyer përherë të vërtetën».

Mirëpo arriti puna gjer aty, sa në shtëpinë e moçme të xha Malos, ku qenë derdhur sa e sa lot grash, nisi të dridhet çdo gjë. Plaku rrinte i ngry-



Përmes vërshimesh

sur sa më s'bëhet dhe vriste mendjen e tij të mpirë për t'i dalë mbanë kësaj pune. Ndoshta, mendonte ai, martesë «me nder» e mbesës do të qe detyra e fundme që duhej të kryente në këtë dynja. Dhe, për të shkuar faqebardhë në atë botë, duhej vepruar siç e kërkonte zakoni. Kështu që i shkrepri në kokë të hiqej si njeriu më fatkeq në fshat e të ndillte mëshirën e të tjerëve. Qëmtonte tërë vuajtjet e hallet nga e kaluara dhe ja zbrazte kujtëdo përpara. Këtë bënte dhe me mbesën, që e kishte tërhequr pas vetiu, si një manare. Një ditë, pasi i tregoi vajzës gjysmën e të fshehtës së tij, plaku ja dha të qarit me ngashërim.

«Thuaj jo, bija ime, se ty nuk të ngasin shumë. . . E, ç'do të mësoh atje? Të mësoh si i bihet kazmës?! Ç'ka për të mësuar njeriu me mend e mëson në vatrën e shtëpisë. . .»

Lotët i binin çurk nëpër faqet e rreshkura e i vareshin gjer nën mjekrën e parruar dhe ai nuk ua priste rrugën. Qante si një fëmijë tekanjosh dhe ndiqte me atë vështrimin e mjegulluar çdo lëvizje që bënte vajza. Priste me ankth e dridhje një përmbysje shpirtërore në ato çaste. Ai priste me besim të verbër që ajo të rendte në prehërin e tij e ta qetësonte. Atë kohë i qenë ringjallur të tëra ndjesitë, madje edhe veshët sikur zunë t'i punonin mirë dhe ai u pështoll nga drithërima e qetësisë përzier me dënësën. Pothuaj pas çdo sekonde nxirrte nga një «oh». Kjo zgjati një copë herë të madhe.

Zemra e vajzës filloi të rrihte me teftik, sikur përpiqej të shpërthente kraharorin e ngushtë e të vërvitej jashtë nga ajo shtëpi e zyrtë. Çdo gjë e dhemshur që e rrethonte dhe që i shpaloste kuj-

timet e vegjëlisë ose i përfytyronte prindët, në ato çaste ju zvordh. Të tëra qenë të lidhura ngushtë me dashurinë për plakun.

«Oh, i ziu unë!»

Dhe dashuria për plakun e gjerë u përmbys aq papritur. Ç'kishte këtu për të qarë e për të thënë «Oh, i ziu unë». Ç'po ngjante? Ç'të qe kjo e keqe e madhe? Ndoshta vajza nuk ishte në gjendje ta kuptonte.

U rrukullis çdo gjë. Vajza nuk nxori zë. Kujtimet e hidhura të vegjëlisë e kishin bërë të heshur. Kurse ato të pakta kujtime të viteve të fundit kërkonin ta rrëmbenin me vete e ta çonin kushedi se ku. Ai djali nga fshati, që bënte ushtrinë andej nga Fieri, i pat thënë se bota është e madhe, e gjerrë sa s'bëhet, dhe hekurudha e Myzeqesë na qenkësh një gjë e bukur.

«Mos rri pa ardhur». Dhe i kishte dhënë numrin e repartit. Ajo e ndjente veten tek bridhte nëpër fushë si në një qilim pa anë e fund.

Pas asaj dite, plaku po brehej më shumë përbrenda. Sa vinte po mbyllej në vetëvete. Heshtja e të dyve u bë si një fishkëllimë therëse për xha Malon.

«Mbaroi», — mendoi ai dhe, i pezmatuar nga që nuk i doli gjë, u përpoq t'i bënte ballë edhe këtij vërshimi.

— Shko, shko, bija e babait... po mos më lër vetëm: më merr edhe mua... «Ta ruaj çupën nga fjalët e botës...»

Kështu ndodhi që ata të shtabit në sektorin e Dushkut kthyen me keqardhje për në fshat një plak të moshuar, që donte të «punonte» me mbesën

e tij. Ai kishte qarë dhe zemrat e të rinjve qenë lëkundur disi.

«Oh, i ziu unë, u turpërova, mbeç i vetëm!»
Kjo i rrihte në kokë si çekan plakut, madje nuk u përmbajt më dhe ja pati thënë copë atyre të partisë në fshat.

— Më muarët më qafë, do të vdes si qeni... kushedi ç'rrugë do marrë çupa...

— Nuk të lëmë vetëm, jo... Gjithë kooperativa do të qëndrojë te koka, — i thoshin të tjerët dhe shkonin më tutje. — Ti, babush, nuk vdes pa martuar Vjollcën...

Dhe atij i bëhej se po pëshpëritnin fjalë të vërteta. Për këto u bind në krye të dy muajve, kur çupa u kthye së bashku me një ushtar.

— Mos e bëj për fjalë, bija ime, si t'i them fshatit?

«I kam gjetur një djalë çupës... Ja, sa të mbaroi ushtrinë...»

Nën strehët e xha Malos nxirrnin krye filiza të rinj.

UDHËVE TË BRAKTISURA

I shte një natë me hënë jo të plotë. Tek rrija e prisja në atë stacion thujse të humbur fushor, ndjeva se po mërzhitesha i mbytur në ca kujtime të errëta e të rrëgjua, që më çonin nëpër skërkat e fëminisë. Sakaq kuptova se do të qe më mirë të dilja jashtë e të sodisja atë mbrëmje të vonët shtatori.

Hëna derdhte dritën e mekur mbi sheshin e asfaltuar. Hija e trupit tim zgjatej e rrëshqiste gjer tutje tek shinat. Nëpër gjysmerrësirë u dëgjua uturima e largët e trenit të fundit, që çante qetësinë e fushës. Ai tren ngjante si i harruar e i lënë pasdore; dukej sikur mbliidhte rrugëve ca udhëtarë kokëkrisur ose të humbur, që s'kishin të bënin me atë botën e madhe e të zhurmshme, që çelet e lëviz me bujë sapo agon.

Kur hipa në vagon, isha i bindur për ato që kisha menduar: katër vagona që i kalova njërin pas tjetrit, i gjeta bosh. Dyert që përplaseshin me forcë pas meje, dukej sikur më shtynin të ikja përpara, të kërkoja njerëz. Vagonat kërcisnin kërr-kërr

dhe nën dritën e mugët të hënës ose të ndriçuar nga ndonjë llampë 40-50 vatëshe, dukeshin të trishtuar. Ky tren ishte i fundit dhe nuk pretendonte njeri për komoditet, por së paku të kishte ca më shumë ndriçim, se kështu udhëtari do ta dëbonte atë mërzinë e zakonshme që të ngjall errësira.

Në një vagon qenë mbledhur nja katër konduktore dhe seç bisedonin me potere. Kur më panë më kërkuan biletën dhe më pyetën siç pyesin nga-hera:

— Këtu hipët ju, shok?


— Këtu, — thashë, ndonëse treni kishte nja pesë minuta që rrëshqiste tutje nëpër natë. Ika dhe që andej. Dera u përplas fort pas meje. Kërkëllima vazhdonte paprerë. Sa hodha disa hapa nëpër një vagon, më zunë sytë një njeri, që kishte zënë një stol të tërë. U kolla me qëllim, kruajta gërmazin dhe, duke pritur të lëvizte njeriu në gjysmerrësirë, instinktivisht më shkuan të ngjethura në trup. Njeriu që ndoshta nuk ishte shtrirë për të fjetur, po për t'u çlodhur, kërcëu përpjetë dhe, si rrëmbeu një bohçe të bardhë që e kishte vënë nën kokë, u ul ndenjor, duke e pushtuar bohçen fort me të dyja duart.

«Ç'pati ky? Ndoshta gabova»...

Bëra sikur ika, me qëllim që njeriu, i cili ishte një plak, ta mblidhte veten. Pastaj u ktheva prapë.

— Mirëmbërëma. S'paska fare njerëz ky tren. Mezi ju gjeta ju.

— Hajde ulu, or' çun, — tha me përtesë njeriu i moshuar dhe bëri mënjanë, duke vënë bohçen në anën tjetër. Ai përpiquej të tregohej i qetë. Fërkonte herë mjekrën e parruar, herë ballin e gjerë plot rrudha të thella.



— Për ku shkon kaq vonë, o xhaxha:

Ai shikoi me bishtin e syrit bohçen dhe me kokën mënjanë tha:

— Atje ku mbaron udha e trenit do të zbres, mor bir, po ç'e do... Sa para bën?! .

Zëri i përçarë i plakut u drodh dhe kjo, me sa duket, vinte nga një dëshpërim i madh, që i kishte pushtuar zemrën dhe e lëndonte orë e çast.

«Njeri i truar paskam qenë... Nuk lashë udhë pa shkelur e derë pa trokitur...»

Plaku dukej i rraskapitur me ata sytë e futur thellë në zgavra. Ai tërhoqi me mundim nën sqetull atë bohçen, që s'e ndante kurrë nga vetja. Dhe, ndonëse ajo bohçe kishte lidhje me vuajtjen e plakut, prapëseprapë nuk e bënte veten. Përpiqej me çdo kusht t'ja hidhte fajin vetes e të mos lëshonte mallëkim për ato çka kishte brenda në bohçe...

Pas një copë here ai e mori veten.

Nën dritën e mekur ai po e ngiste bisedën me gjallëri, aq sa dukej sikur nga çasti në çast do të shpërthente në gaz të pafre. Ç'e shtynte të bënte këtë? Mos vallë atyre udhëve që kishte bërë ditë me radhë e kishte ndjerë veten të mjerë e të braktisur? Dhe ndoshta i pat humbur shpresat për t'ja arritur qëllimit. Ai po përgatitej qëkuri, që më në fund të zbrazte hem bohçen, hem barkun, të hapte zemrën.

— Mezi e gjeta, mor bir, po ç'e do... Sot është vonë... Sa para bën!.. Sot...

Kështu dalëngadalë plaku zuri të lëvrinte e të ngiste bisedën më tutje... Dhe tërë kjo shëmbëlente sikur njeriu po dilte nga një grykë tuneli,

duke prurë me vete erëra që të ngjethin mishtë...

... Kthimi i djalit nga ushtria e kishte mbushur shtëpinë me një gaz të vërtetë. Këtë afërmendsh e shtonin së tepërmi dy ngjarje të shënuara për familjen: martesja e djalit dhe e vajzës në një ditë. E kishin shoshitur mirë çështjen, bile edhe me shokë nga të frontit, që me një harxh të nxirrinin çupën nga shtëpia e të fushin nusen e djalit në shtëpi. Gratë e moshuara, nga ana e tyre, gjithashtu patën dhënë pëlqimin.

«Kështu nuk do ta ndjejmë largimin e çupës».

Çdo gjë po shkonte mbarë, si jo më mirë. Harreja e dasmës që do të bëhej së shpejti, u ndje në tërë fshatin. Në shtëpi ca më shumë. Ndërsa tek plaku gëzimi i përmbajtur përzihej me një shqetësim që i dridhte zemrën. Thellë në shpirtin e tij po ndodhte diçka që i përngjante një parandjenje të keqe. E, meqë ai ishte njeri i rrahur nga jeta, bënte çmos për të mposhtur në daç frymën e gëzimit, në daç tronditjen e të papriturave. Sepse vetë jeta me andrallat e saj e kishte bërë plakun të matur në gëzime dhe të fortë e të përmbajtur në hidhërimi. Doemos, në shpirtin e tij nuk kishte se si të futeshin të heshtura ngjarjet. Ato e lëkundnin përbrenda, thellë mu aty në gjoks. Po ec e merre vesh ti se ç'vlon thellë, në qenjen e një njeriu, që shprehet vetëm me dy tri fjalë në çdo rast.

«Më bëhet qejfi» ose «Xhani ma di...» Kështu ndodhte edhe me plakun. Ai ishte i dehur nga dasma e madhe. Ditët po shkurtoheshin dhe ai s'bënte zë, përkundrazi, një heshtje e pakuptuar i qëndronte mbi kokë. Vetëm me djalin që sapo ishte kthyer nga ushtria këmbente ca vështrime të dyshimta

tek gjendej përballë tij. Tri ditë para dasmës, atë e bir qenë ndarë pa u marrë vesh e pa rënë në ujdi dhe tamam atë ditë plakun e kishin parë udhëve tek zbriste nga fshati.

«Hallet e dasmës për ne pleqtë janë...». Mendonin të moshuarit, siç bluante në mendje edhe vetë plaku, që kishte marrë udhë të gjatë.

«Ne turpërohemi... E mori nusen lakuriq. Nuk pati takat, do të thonë».

Udha e gjatë nisi më këmbë, vazhdoi me kamion, me tren dhe mbaroi prapë më këmbë. Ashtu i kërrusur e i këputur nga lodhja plaku kishte trokitur në dyert e miqve të qytetit, por e kthenin duarbosh dhe atij i copëtohej zemra.

«Fustan e vello për nusen?! I kemi braktisur këto...» I thoshin dhe këmbët e plakut travatisnin udhëve e duart trokisnin dyerve të tjera. Ditën e parë kishte harxhuar ca para për kamion, për restorant e hotel, për tren, por ato s'qenë hiçgjë përpara shpenzimeve që kërkonte kostumi i nuses. Në fund të fundit ato para që kishte hedhur në bankë ishin llogaritur se qysh do të harxhoheshin e përse... Ai do të bënte dhe aheng, aq sa i ngrinte kandari... Kështu që nuk harronte që në çdo derë ku trokiste, të bënte edhe ftesë për dasmë.

«Mirë të kanë thënë. Ashtu është: kam pasur vello të mirë, po nusja e bëri mbulesë për krevatin e foshnjës...»

Plaku nxirrte ndonjë rënkim të mbytur dhe ikte më tutje.

«Të më urdhëroni në dasmë», thoshte.

Ditët e para nuk e kishte ndërë aq shumë lodhjen dhe pagjumësinë. Ato dy ditë ndoshta e mbante shpresa për ta gjetur më në fund vellon e

nuses. Bile dhe mendja i thoshte se do të arrinte t'ja shpinte krushkut. Dhe ky, krushku, që e priste këtë, kishte për t'u çelur në fytyrë. Do t'i bëhej qejfi kur ta nxirrte të bijën me vellon e nusërisë, hedhur mbi fytyrën e bukur.

Mirëpo, që kur se agoi dita e tretë, plaku e ndjeu shumë drobitjen. Me shpresa të humbura ecte anës atyre udhëve, që i dukeshin të braktisura e mezi mbushej me frymë, duke thithur poshtë tymin e farmakosur të duhanit.

«S'do të kisha bërë keq, — mendonte, — sikur të isha fjalosur edhe për këtë me ata të frontit. Beqma do të më ndihmonin...»

-- Në të thyer të ditës së sotme — ja bëri plaku më në fund, — më qeshi buza kur s'e prisnja. «Shko një herë atje», më thanë e më treguan një shtëpi. Kur më nxorën vellon e nusërisë përpara, nuk po u besoja syve. Më qenë veshur sytë.

«Mos e nxirr kuletën. S'më duhen paratë e tua, jo. Do të ma blejë muzeumi. Ti vetëm ma ruaj e ma kthe pas një jave». Kështu më thanë. Mua më dridheshin duart. Kuleta më ra përdhe. «Ç'pate, o i uruar? Hajde të pish një kafe, të mbledhësh veten, pa të ikësh», më thanë. Uñë nuk e piva kafënë, po ika. Duke ikur, i thashë atij njeriu të mirë që të më urdhëronte në dasmë.

«Të trashëgohen e me këmbë të mbarë!» — më thanë. «Ik, o i uruar, ik!»

I pështolla ç'më thanë në këtë bohçe, i futa nën sqetull dhe hë këtu e hë më tej, arrita siç më shikon.

Plaku e preu fjalën, bëri të mbushet me frymë, po e zuri një kollë. Ai nxori një shami të madhe

pështjell'ë shuk, e shkundi dhe fshiu me të hundët, buzët dhe mjekrën e parruar.

— Ç'e do... sot është vonë. Sa para bën!.. Sot... — fliste ai me zë të shuar, sikur ato udhë që kishte bërë, t'ja kishin përpirë fuqitë.

Më erdhi keq sa s'bëhet për atë plak, që ishte endur atyre udhëve dhe, pa u thelluar, i thashë:

— Po përse nuk nise tët bir?

— Nuk më dëgjoi. Sapo u kthye nga ushtria, siç të thashë, ka ndërruar shumë.

Tamam sikur të m'i kishte kuptuar mendimet, plaku shtoi:

— Mirë të na e bëjnë bijtë!..

Tërë ato që kishin ngjarë me plakun gjatë atyre ditëve, patën lënë tek ai gjurmët e lodhjes e të mundimit të kotë. Por mbi të gjitha, në sytë e tij të shuar e të kredhur në ca zgavra të errëta shquante humbja e shpresave dhe pikëllimi. Këto i vura re që kur se u ula pranë këtij njeriu. Ato fjalët e tij: «Ç'e do... Sa para bën?..» ndonëse të lëna përgjysmë, tregonin haptazi se, me humbjen e dasmës, plakut nuk i lipsej më asgjë. Kishim një copë herë të gjatë që rrinim në heshtje dhe, siç duket, ashtu do të vazhdonim gjersa treni të qëndronte në stacionin e fundit. Aty, ne kishim për t'i lënë shëndenë njëri-tjetrit dhe kaq.

Kështu ndodh zakonisht me udhëtarët. Ata i hanin zemrën shoku shokut ndoshta më shumë sesa kërkohet në raste të tilla dhe bëhen të afërt. Mirëro, ia ku vjen stacioni i ndarjes dhe njerëzit shkëputen pa vonesë. Tek disa është zakoni që të përçafohen, bile edhe të puthen, për të shprehur miqësinë oë i lidhi fort në rrugë e sipër.

Kaq mund të bëjnë udhëtarët për shoshoqin

dhe për ca kohë e fusin tjetrin në biseda nga më të ndryshmet. Si zakonisht, këto biseda nisnin kështu: «Po udhëtoja një herë... Kam njohur në udhë e sipër... Ishte një njeri i çuditshëm që më bëri për vete... Kishte një histori interesante ai... M'u dhimbs ai...» Dhe mbarojnë: «Më tutje nuk di, se u ndamë».

Kështu po mendoja në atë kohë, ndërsa në mendje po më lëvrinte një ide guximtare. Skapamentot e një motori që po ëndërroja, nisën këngën e tyre në veshët e mi. Me të drejtë mund të më kritikonte kushdo nga shokët sapo që të merrte vesh për çka po mendoja. Si vendosa unë, një i ri të bëhem transportues i vellos? Me sa mend në kokë po dëshiroja që ajo bohçe të arrinte sa me parë? T'jua them troç, edhe plaku m'u dhimbs, edhe interesi im si mbledhës folklori më joshi në atë fshatin e largët. Se do të ngjiste diçka në atë dasmë, nuk e prisja... Skapamentot tani më buçisnin me vendosmëri në vesh. Vetëm sirena e lokomotivës m'i preu në mes të tëra ç'kaloja nëpër mend. Plaku, që ishte mbytur në hallin e tij, u drodh sikur ajo ta-ta-tra-taaa, që lajmëronte stacionin e fundit, të qe një tryelë që po i hynte thellë në gjoks dhe po i zinte frymën.

— Eh, sikur të bënte edhe ca më tutje ky tren i uruar!..

Ai pushtoi nën sjetull bohçen dhe duke u lëkundur, u çapit për të dalë nga vagoni, që frenoi duke lëshuar në errësirë një gërvimë. Ajo gërvimë plakat ju duk si një çark i ngritur aty, poshtë shkallëve, që priste ta mbërthente nga këmbët. Kur pa, që unë po i shkoja pas, me sa duket bëri përpjekje dhe e mblodhi veten.

— Të më urdhërosh në dasmë! — tha dhe bëri të ikë.

— Ku do të flesh sonte?

— Do bëj udhë, mor bir. Edhe ndonjë sy gju-më udhëve do e marr. Çupën s'e arrij dot. Po nu-sen e djalit kam shpresë ta zë...

«Dasmë e madhe!» mendova

— Cilën rrugë do të marrësh? — pyeta.

— Xhadesë... ja bëri plaku, duke treguar me kokë nëpër natë, andej nga niste ajo xhade e shkretë e me gropa të shumta.

Ta-ta-tra-taaa u dëgjua sërishmi sirena dhe çau me dridhje errësirën. Maqinisti e kishte bërë zakon që të përshëndeste qytetin në ato orë të vona, apo jepte sinjalin që po nisej në shtëpi dhe atje të bënin gati darkën e vonët?

Nja gjysmë ore pasi isha ndarë me plakun, me një motoçikletë «Java», që ja mora rrëmbimthi me një shpjegim të shkurtër një shokut tim agromom, nisa të troshitesha xhadesë plot me gropa. Plaku më doli përpara dritës i vendosur të më ndalonte. Sytë e tij, që ca më parë më qenë dukur fare të shuar, shkrepëtinin thellë, thellë. Fytyra e tij qeshte dhe lutej në një kohë.

Udhës, megjithëse nuk e shihja plakun, ndjeja se ai ishte gjallëruar. Shpresat e përtëritura kishin prurë me vete gëzimin.

«Të troshitka më keq sa mushka ky», më thoshte herë-herë. «Ç'ka që tërbohët kështu?» pyeste kur unë i shtoja gazin. Nja dy herë na u desh të ndaleshim, se ju rrezua bohçja. Skapamentua kër-ciste pareshtur nëpër natë. Ne afroheshim, pa e kuptuar, më pranë dasmës.

«O, ç'm'u mpinë këto të shkreta», — ja bëri

plaku me vete dhe mendoi: «Ne pleqtë vetëm kockat kemi në të ndenjura; ku na vete ky i uruar mish, që fishkemi kështu?»

Ai zbriti nga shala e prasme dhe ndenji një copë here i kërrusur e me duar në ije. Ndjente një topitje të madhe. Por në atë kohë vihej re tek ai një farë mëdyshje në veprime.

Plaku përpara e unë pas u çapitëm drejt hyrjes së shtëpisë. Ai nuk u fut drejt e brenda, si në shtëpinë e tij. U afrua tek dera gjysmë e hapur e që andej hodhi vështrimin e tij, që ruante ende trishtimin dhe lodhjen e rrugëve që kishte bërë. Vërejtja me kujdes dhe hetoi me sy ata që ishin pranë tryezës së dasmës. Donte të dinte nëse ndonjeri do ta priste me këmbët e para dhe kush duhej të qe ai. Si bëri tërë këto, në gjysmerrësirë kërkoi dorën time dhe më tërhoqi për nga dera. Atë çast një grua e re, që mbante përpara gjirit një sini me thela mishi. nxori një «oi» dhe bëri mënjanë, sikur me këtë gjest kërkoi ndjesë që më goditi në kurriz.

— Mirse rrini e mirse pini! — tha plaku me zë të pakët, gati të shuar. Atë e ulën në qoshe, e pyetën si kaloi; më dhanë të njohur mua dhe nisën me urime e këngë. Për rrobet e nuses, nëse i gjeti apo jo, asnjëri nuk u interesua. As të shtëpisë as të jashtmit. Kjo e mundoi plakun, po vetëm për disa çaste, se më pas e zuri gjumi dhe ai nuk mori vesh ç'ndodhi më tutje.

Të nesërmen, me të rënë rrezet e para të diellit, në oborrin ku kishte dasmë, qenë mbledhur jo vetëm fqinjët, po edhe shumë fshatarë të rinj e të moshuar. Dukej sikur qenë thirrur nga organizata e rinisë e nga këshilli për mbledhje, aq shumë ishin dhe diçka prisnin. Në disa dasma që ishin bërë më

përpara, nuk kishte pasur kaq shumë njerëz. Plakut i bëhej qejfi dhe s'donte të vriste mendjen për asgjë. Ndjente akoma drobitjen e rrugëve; kënaqësia që më në fund fustani dhe vellua e nusërisë ishin çuar te krushku që mbrëmë natën, e gëzonte pa masë. Atij ju bë sikur në ato çaste, po i rriheshin para syve tërë ato dasma të kaluara gjatë gjithë jetës që kur mbante mend.

Në fillim ndjeu gëzim e trishtim së bashku për çka solli ndër mend, pastaj ndjeu neveri dhe u zvordh nga ato kujtime, duke i shtyrë me një të pështyrë ca më tutje këmbëve. Fshiu lëkurën e rreshkur të buzëve e të mjekrës dhe u drodh. U duk se edhe foli nëpër dhëmbë, ndoshta hodhi ndonjë të sharë, që s'i kursente shumë. Hoxha dhe shkasi qenë dukur në kujtesën e tij. Ata nuk mund të ndaheshin nga ato dasma. Ata u ngërdheshën në mendje të plakut. Dhëmbët e tyre të krimbur mezi shquanin nëpër gojët si zgavra të errëta. Avujt e frymëmarrjes së tyre dilnin që andej si një erë skëterre dhe i binin plakut në fytyrë dhe atij i vinte të pështirë. Bënte kokën mënjanë. Pështynte. Ngërdheshjet s'donin të iknin. Ato kishin punë me plakun. Ai shante. Ngërdheshjet çireshin: «Gëzohesh që na shporre ne, ë?»

— Tfu! — Plaku ngriti kokën e rënduar, hapi me mundim sytë dhe në vështrimin e tij, që sapo doli nga një errësirë pus, u shfaq një dritë qumështore dhe e mjegulluar. Ai po dilte nga një ëndërr e zymtë. Po dilte nga errësira nëpër mjegull... Ajo copë mjegull që ju shfaq papritmas u bë më dysh, më tresh, më katërsh. Nëpër të çara shpërtheu një kaltërsi që zbriste nga majëmalet.

Plaku tundi kokën. Pështyu. Shau pa kuptim.

Ai kishte dalë nga ëndërra. Para syve, ja ku i qëndronte e bija, që mbante në duar copa nga vellua e shqyer.

«Ç'pati? E prishi martesën? Po, ata qeshin! Thërresin «rroftë Enveri!» U prish edhe ky zakon...»

Plaku u shkund dhe nisi vrapin me sa fuqi që kishte, andej nga mëhalla e krushqve të nuses.

«Do më prishin vellon e mikut, o-po-po!..

NJË FLUTURIM I ZAKONSHËM

Po afronte mesi i natës. Ai u çapit me kujdes nëpër dhomë që të mos shkaktonte qoftë edhe zhurmat më të vogla të përhapura nga këmbët e zbatthura. Nën dritën e mekur të neonit, që hynte përmes tyllit nga bulevardi, ai shqoi gjithë sendet. Një copë herë ndenji me sy gjysmë të mbyllur, që të ambientehej më mirë me atë ndriçim të pakët. Atë çast frymëmarrja e shtruar, e thellë e gruas e qetësoi dhe i ndolli kënaqësi. «Sa mirë që po fle!»

Por, ndërkaq, trupin ja përshkoi një drithmë dhe ndjeu të ngjethura. Qindra net ai kishte ardhur në këto orë të vona në shtëpi dhe, duke nisur që poshtë shkallëve, pati vepruar njësoj: hidhte sytë në dritaren e apartamentit në kishte apo jo dritë, buzëqeshte, belbëzonte edhe ndonjë fjalë, niste të rrëmonte xhepin e zakonshëm për të nxjerrë çelësin, lironte duart duke i vënë sendet si shlemofon e planshetë nën sqetull, hapte derën me kujdes. . .

Të tëra këto i qenë bërë shprehi dhe ishin aq të


domosdoshme, sa edhe ato që i lipsen aviatorit për të fluturuar i qetë kurdoherë. Dhe shprehitë, siç dihet, nuk humbasin lehtë. Ndaj, edhe atë natë të vonët ai bëri po ato veprime gjer në çastin kur u ndodh në mes të dhomës, ku flinte e shoqja. Tani i mbetej të zhvishej po me aq kujdes e të ndente shtatin për t'u shlodhur gjatë asaj gjysmë nate që kishte mbetur. Pilotit i duhet shumë të pushojë pas fluturimeve, doemos, ca më tepër pas fluturimeve të natës. Po atij, ç'i lipsej gjumi atij?

Hapi mirë sytë dhe vështroi prapë gruan në flinte vërtet. «Sa mirë që po fle!» mendoi sërishmi. «Sa mirë!» dhe buzëqeshja e zakonshme i ngriu në çast. E njihte mirë atë grua gjatë njëzet vjetëve të jetës së përbashkët. Ishte një njeri i rëndomtë, po që ndokujt do t'i dukej si ata që e kalojnë kufirin e kujdesit në familje dhe bëhen të ngurtë e të kalkuluar sa të mërziten. Kështu që edhe ai vetë ditët dhe javët e para të martesës ushqeu dyshime, saqë filloi t'i shfaqte, natyrisht me të qeshur, ndonjë mendim.

«S'të njoha kështu atëhere, — i thoshte. — Ke ndryshuar sa s'bëhet hesap, njëqind e tetëdhjetë gradë».

Ajo nuk bëzante me qëllim që të dëgjonte e të dëgjonte prej gojës së tij. Të merrte vesh në fund të fundit qëllimin që e udhëhiqte në jetë.

... Ashtu i ndrojtur e fjalëpakë, me mendime të shumta në kokë, flokëpakrehur kishte hyrë në dyert e një shkollë, nga ku do të dilte ndoshta aviator. Ndonjëri mund të thotë se s'ka njeri në moshë të rinisë, që të mos ëndërrojë të bëhet diçka i jashtëzakonshëm, si fjala vjen marinar, pilot, tankist. Ndërsa ai nuk do të shprehte ndonjë dëshirë



Një fluturim i zakonshëm

të zjarrtë për këto profesione ushtarake, veç një aprovimi të vagët, në mos të ftohtë.

«Dakord».

Aty në shkollë kuptoi se ky profesion nukë genka aq i rëndomtë, sa ç'mund të mendohet nga ushtarakët e llojeve të tjera të armëve. Pas fluturimit të parë në pilotazh të plotë kishte dalë nga kabina me çehre të vrarë, të pikëlluar, sikur përpiqej t'u mbushte mendjen shokëve: s'kam ç'bëj, nuk ja dal dot mbanë. Për të mos e shtyrë punën më tej, si e shoshiti mendimin në kokë të vet, i dha udhë që një ditë prej ditësh të shprehet hapur: «Punë që s'bëhet, shokë».

Shokët u drodhën dhe i hodhën ca vështrime hetuese nga koka te këmbët: Ç'thua, more derëbardhë!

— Do hedh lutje. Nuk mundem më...

— Ti po na turpëron. E kupton këtë, apo jo? Kujt i bën lutje ti? Kush je ti? Tërhiqesh, hë? Me ç'sy e faqe do të dalësh para shoqërisë... Je në vete, apo jo? Në të ka plasur cipa, bëj si të duash, xhanëm... Po dije se na turpëron edhe ne kështu.. Tërhiqesh...

Atë bombardim qortimesh, që i ra me tërsëllëmë mbi kokë, zor se do ta harronte ndonjëherë. S'qe mbushur as viti nga dita që ju bë mendja top se kjo punë nuk bëhej, kur zuri të ndjejë se era e benzinës po i pëlqente. Ca nga ca, për të po muguillonte një jetë e re, në fillim e panjohur, thaujse e dvshimtë. por që më pas u kthye në një fushë reale, ku do të vepronte. Nisi t'ja trazojë shpirtin ajo garë e nashballur në mes shokësh se kush mund të fluturonte më mirë. Kureshtja e parë që kanë njerëzit për gjërat e panjohura dalëngadalë qe

shuar, po sakaq, pa u ndjerë, i pat lindur një dashuri për qiellin dhe digjej si ai prushi nën vete. «E, si do bësh? — e ngisnin shokët. — Do ta hedhësh lutjen, apo e le mënjanë?» Ky tundte mendueshëm kokën dhe ja bënte: «Qenka si afshi i rakisë kjo e shkretë benzinë, . . . Po të hyri në gjak, zor ta braktisësh. . .» Kështu i përpirë nga shqetësimet e panumërta e të përditshme, koha i kalonte rrëshqitaz e tinëz, pa u vënë re nga ai. Vetëm ajo shikonte se vitet po linin gjurmë në tëmthat e aviatorit, duke ngjitur përherë e më shumë nga një thinjë të ashpër.

«Ti ke nisur të lodhesh. Pusho ca. Mos ngul këmbë, se nuk je ai i pari. . .» i pat thënë ajo një ditë. Dhe aviatori i kishte pritur me qetësi këto fjalë, që goja e saj i thoshte përsëpari.

«S'qenkam ai i pari, ë?! . . .» digjej përbrenda. Sidoqë edhe mjeku i repartit dikur qe shprehur rreth moshës dhe rrallimit të fluturimeve, ai për një kohë nuk po merrte vesh dhe vriste mendjen se ç'qenë këto, këshilla apo, shenja të liga për pilotin. Vetëm pas disa vjetësh çdo gjë zuri vendin e vet dhe ndërkaq ai kuptoi se «pleqëria e pilotit», si çdo pleqëri, të pushtoka fshehurazi. Ajo mbuloka kokën si një mjegull e bardhë dhe mbetka si brazima nëpër fiiet e barit të vjeshtës.

Dy vjet kishin kaluar si ndër ethe. Nuk po i besohej se ndarja me qiellin ja ku qe, fare pranë.

«Një mjek e kam në repart, edhe ti në shtëpi na duhesh», — i zbrazej së shoqes sa herë që i takonte të shqetësohej për këtë punë. Kohët e fundit thoshte me vete: «Së paku ta shtyja edhe ca. . .» Mirëpó, kush të pyet? Jeta bën të sajën, frap, ta pret udhën në një drejtim. Dhe hë, si do të bësh ti? E

dimë që të dhimbset ajo rrugë, dëshira e qëllime të mëdha të joshin të ecësh nëpër të... por rrugët e kanë një mbarim, do apo s'do ti. Kështu që, në vjeshtën e jetës tënde, të jepet rasti të nisësh një tjetër udhë të re...

Detyra e shefit të shtabit po fillonte ta gudu-
liste e ta fuste në ato andrallat e shumta. Ndoshta,
ai pasion i vjetër për qiellin, kishte për t'u mbuluar
nga planet, grafikët, shkresat, urdhërat, telefonat,
që futeshin me alarm në atë zyrë. Zyrë. Ç'copë të
ngushtë që i lanë në pjesë! Ku krahasohet ajo me
aerodromin, me qiellin.

Dhe ja ku erdhi nata e parë e fluturimeve. Ai
këtë natë ishte organizator i të tëra veprimeve, në
daç edhe i lëvizjeve nëpër fushën e gjerë. Kishte të
drejtën e urdhërave me rëndësi. Fjala e tij zinte
vend... por, vetëm këtu në tokë; në qiellin e asaj
nate, ai s'kishte punë...

Tani ishte kthyer në shtëpi dhe tek qëndronte
më këmbë, ai sillte nëpër mend ngjarjet e dikur-
shme, të cilat po i ngjallnin një shkëndijë gëzimi.

«Sa mirë, që ajo po fle!» — tha për të tretën
herë dhe hodhi vështrimin në tryezën e rrumbu-
llakët, ku gjendej abazhuri rozë. Le që, ç'rëndësi
kishte nëse gruaja flinte, apo jo. Ai nuk fluturonte
më. Ai ishte një shef shtabi dhe, po të qe nevoja,
mund të rrinte tërë natën pa gjumë. Këshillat e kuj-
desi i saj nuk vlenin më. U ul pranë tryezës. Rreth
asaj tryeze ku do mblidheshin netve pa gjumë sa
e sa shokë plot ngjarje dhe aeroplanë. Abazhuri
lëshoi një gjuhë drite rozë mbi fletoren e sapoçelur.

Në atë gjendje shpirtërore që ndodhej, i ulur
pranë tryezës së vogël, përpiquej të rrëmonte në
kujtesën e vet atë çka kishte ndjerë dikur. Çfarë

duhej bërë? Të qëmtonte në mes qindra e qindra fluturimeve ato më interesantet? Po cilat qenë ato më interesantet? Se mos u bë aviacioni lojë futbollit!...

Në kraharor po i digjej e përflakët diçka që e gëzoi dhe e stepi një copë herë. Kuptohet se duhej nisur jeta e qiellit përsënjëzaj. Kjo e gëzonte dhe e trishtonte. Ndaj nëpër kujtime nuk do të mund të largonte edhe ndonjë fill mallëngjimi.

«24 prill 1951. Të pesë aeroplanët janë rreshtuar në barin jeshil përpara hangarit. Ata na presin ne, pesë pilotët e rinj shqiptarë. Dha urdhër Partia, shoku Enver, që të ngrihemi më lartë se shqiponjat e t'i hedhim një copë çati Republikës...»

Ky natyrisht që një fluturim i zakonshëm, në formacion pyke, me pesë aeroplanë. Por që ndoshta pasardhësit do ta përmendnin me respekt. Kjo nuk dihej nga ata të pesë... Ja, që këtej ai donte të niste atë natë kujtimet e veta për jetën e qiellit, nga e cila pak ditë më parë e kishte ndarë jo pa dhembje «pleqëria». Disa nga shokët që patën luf-tuar malit kundër fashizmit, ranë në krye të de-tyrës pas luftës, duke u përpjekur që «t'i hidhnin një copë çati Republikës». Të tjerë vazhdonin. Ai po niste kujtimet dhe do të deshte që ato të mos shteronin kurrë, për tërë jetën, e t'ja mbanin nde-zur atë prush, që zuri të digjej në qenjen e tij njëzet vjet të shkuara.


MOS MË HARRO, KOMANDANT!...

Hej, moshë e rinisë! Ç'është kjo moshë e rinisë! Si fluturojnë vjetët në këtë moshë!

Para tre vjetësh u vësua me kapotën e murme, me atë kapotën sa të ngrohtë, aq edhe të thjeshtë. U vësua ushtar. Vija nga fshati: unë atëhere çuditësia me tërë ato që dëgjoja në ushtri. Komandanti më thoshte: «Mbaje hapin... Pastroje pushkën përditë... Hap gropa ullinjsh me lopatën e xhenjerit... Mëso të qëllosh armikun me një prehtë...» Dhe unë vrisja mendjen se ç'lidhje kishin të gjitha këto.

Hej, moshë e rinisë! Sa jam rritur këto tri vjet! Atëhere, kur sapo kisha veshur kapotën e murme të ushtarit, s'më hiqeshin nga sytë ugaret, arat e mbjella dhe ndjeja pareshtur erën e tokës tërë vlagë. Tokës i ndjeja edhe rrahjen e damarëve...

Mezi u ndava nga gjiri i nënës, që më fliste për eshtrat e babait atje, tek varrezat me yll të kuq. Me lot në sy u ndava nga të afërmit. Mos u cuditni, se për herë të parë largohesha nga shtëpia. O, sa më dhimbsheshin! Më dhimbsheshin njerëzit,



arat, bagëtia, drurët dhe gurët... Mos ma merrni për dobësi...

Hej, moshë e rinisë! Sa jam rritur këto tri vjet!...

Mirupafshim, shokë! E zhvesha kapotën e murme të ushtarit, e dorëzova pushkën numër 1424, e hoqa bustinën me yll... Ja lashë një të riu tjetër. Por peshën e kapotës, të pushkës hedhur në krah dhe të bustinës mbi ballë, nuk munda t'i lë... Nuk munda. Ato do t'i mbaj mbi shpatulla për tërë jetën.

Ç'ledhatim të ashpër më dha ushtria! Po iki, shokë. Po ikim ne përmes kësaj vjeshte të artë, po hedhim hapin ushtarak mbi gjethet e verdha, pa komandë dhe pa pushkë...

Përsëri ndarje... Përsëri lot dhimbsurie, kësaj radhe për shokët e armës, për ty, komandant. Mos e quani se prekem shpejt, mos e quani se derdh lot kot së koti për këdo e kudo. Asnjë pikë... Jo, unë jam një fshatar i ashpër, i rrahur nga era e dielli; unë jam një bredh në mes të suferinës. Unë tani jam një bredh i lartë që çjerr e përplas tutje retë e zeza, që mund të më sillen mbi kokë. Unë jam një ushtar, që di të luftojë me pushkë e pa pushkë...

Po iki përmes vjeshtës së artë dhe do të kalojnë stinët mbi mua, pa mundur të më zhveshin blerimin e përjetshëm të bredhit.

Mos më harro, komandant! Unë do të mbaj mbi të gjitha uniformën e blertë!... Më ke në rresh-tin e parë, se jam një bredh i lartë... Jam unë, ushtar Iliri, i çmobilizuar sot.

Eci përmes kësaj vjeshte të artë, pa kapotë e pa pushkë, por ndjej ngrohtësinë e asaj kapote dhe peshën e pushkës që lashë... Eci me hapin ushta-

rak pa komandë, përmes arave. Eci dhe më duket se këto toka djerre me bajoneta do t'i çaj. Jam këtu, në mes gjelbërimit i maskuar, i veshur me uniformë të gjelbër. Më bëj zë, kur të jetë nevoja, dhe më ke aty, në rreshtin e parë, komandant!

Tani po eci nëpër ugarë, brazdave, ku lëshohet fara, dhe më ngjan se jam nëpër transhe, në brezin e parë të sulmit.

Mos më harro, komandant! Më ke aty, në rreshtin e parë, ndonëse eci nëpër brazda duke hedhur farë. . .

TEKNIKËT

Teknikët e aviacionit janë njerëz të thjeshtë, të heshtur dhe aq punëtorë, saqë shpesh edhe bukë harrojnë të hanë. Po, po, më besoni për këtë. Vetëm se rrallë dhe fare pak është shkruar për ta. Gjilhmonë: «Piloti», «Piloti gjuajtës», «Komandanti i zvenos sonë». E sa e sa shkrime të tjera tregojnë për pilotin, kurse për teknikët hidhet nga një fjalë shkarazi.

Unë s'e ndjej veten mirë kur më vjen ndonjë prej tyre e më thotë: «Kishe shkruar një artikull... Pilot i mirë është filani, për të cilin bëje fjalë...» Dhe më shikon në sy. Mua më duket se thotë: «Je bërë egoist... Vetëm për zanatin tënd shkruan...»

Nejse. Sot vendosa: të bëj si të bëj e të shkruaj për ta, për duart e tyre të arta, për ata që janë të lidhur si mishi me kockën me pilotët...

Nëpër mugëtirën e mëngjezit, njerëzit e veshur me kominoshe lëviznin me shkathtësi. Ngjiteshin nëpër shkallë, zbrisnin, rrotullonin helikën, linin kaçavidën e merrnin pincat dhe, megjithëse gjummin e kishin lënë mangut, fytyrat e tyre dukeshin

të freskëta. Ndonjë tingull i lehtë metali, që dilte tek-tuk, e gjallëronte aerodromin e mbuluar nga mjegulla.

Dhimitri, Nikua, Gaqua, djem të rinj, që i ëmbëlson gjumi i mëngjezit, janë çuar që me dy orë natë. Ndryshe pastaj qëndron puna me specialistin Andrea. Ky «u plak» në aviacion. Nuk i duket punë po që se shkon në repart në ora shtatë. Ja edhe Sadiku, i pakët nga trupi, po i gjatë, me shlemofon në dorë, shkon avion më avion, duke folur me zë të lartë e me romuze, pa pyetur nëse muhabeti i tij u pëlqen të tjerëve. «Mos ja vini re, — pëshpërisin teknikët, — ai është radist, e bën zanati të flasë papushim që me natë... Duhet provuar radiot!» Sadiku ecën në punën e tij e duket sikur nuk ua vë veshin këtyre fjalëve.

Mjegulla e dendur mbulon lëvizjet e shkathëta të teknikëve dhe mbufat zërat e ulët. Vetëm ndonjë tingull metali çan ajrin e ngjeshur e dëgjohet gjer larg.


— Gaqo! — thërret me zë të ulët Nikua dhe kujton fjalët: «Këtu duhet punuar me shumë kujdes. Ja, po ta tregoj unë si bëhet, që të mos gërvishtet metali. Gërvishtja është shenjë e punës pa kulturë... Në avion e motor s'duhet të ketë gërvishtje dhe goditje...» Vërejtja e inxhinierit ishte me vend, ashtu duhej, por...

— Gaqo, — thërret prapë Nikua.

— Ti fole? Ja erdha — u përgjegj ai si nëpër hundë dhe u drejtua nga avioni me numër dymbëdhjetë.

— S'po ja dal dot...

Në kabinë u dëgjuan këmbë të rënda. Pastaj bum, kërceu poshtë Sadiku:



— Gati radioja. — Hej, ty të them, bjere ta firmos. Pajimet e radios gjithmonë gati!

— E bën profesionin... — murmuriti nëpër dhëmbë njëri dhe qeshën të dy.

Gaqua po rregullonte një detal në motor.

Nikua shikonte i menduar.

— Kjo s'është asgjë... Ja, mbaje këtu me pincën, kurse me kaçavidën... Ja. Vetëm kujdes, — thoshte Gaqua dhe shtrëngonte buzët duke punuar.

— Vazhdoje vetë tani, se edhe unë kam kontrollin e sistemit të frenimit.

... Dielli kishte lëshuar rrezet e para matanë maleve. Mjegulla sa vinte përndahej.

— E çuna, si dukeni? — pyeti inxhinieri, që nisi të kontrollonte punën e teknikëve për atë ditë.

Kontrollonte me kujdes e vëmendje. Ai prekte me dorë çdo gjë. Tekniku, me fytyrën plot sumbulla djerse, qëndronte më këmbë. «Atë e kemi bërë bashkë me Gaqon, shoku inxhinier», desh t'i thoshte Nikua. Por heshti.

— Kur të kesh gjë të paqartë, pyet shokët. Ata i ke më afër... Dokumentimin e ke bërë?

— Siurdhëron!

Pikat e vesës, që kishin rënë mbi avion nga mjegulla e natës, ndriçonin si rruaza të kristalta. Ato rrëshqisnin e binin poshtë.

Një erë e lehtë, që vinte nga ana e lindjes, për-kuli fijet e barit. Nisi një fëshfërimë dhe nanuritje jetëdhënëse, e përzier me cicërime, dihatje dhe tinguj. U bë zgjimi i plotë i natyrës. Hymni i punës u ngrit deri lart, në kupën e qiellit.

Aeroplanët fluturonin, ata muarën rrugën ajrore në freskinë mëngjezore. Teknikët mbetën poshtë. E, megjithatë, shikimet e tyre nuk shqiteshin

nga aeroplanët, derisa ata zhdukeshin tutje, në brezin e murmë të horizontit. Pastaj vijnë minutat e pritjes. Ata ndejnë thellë punimin e motorit, si punimin e zemrës së tyre.

... Tekniku Niko ecën poshtë e përpjetë nëpër një copë vend, që është rrahur më shumë nga rrotat e aeroplanit. Në një anë janë vendosur shkallët dyshe, bombola zjarrfikëse, ca flamurka, të tëra këto në ngjyrë të kuqe. Ashtu trupvogël, ai ngjan si një rruzull që rrukulliset anës, përqark sendeve. Ndez edhe një cigare; gjashtë bishta cigaresh janë shtypur aty në atë copë vend. Kështu që pesëdhjetë minuta po kalonin nga ora e caktuar dhe aeroplani nuk po dukej gjëkund. Tekniku zaptonte horizontet me sytë e vegjël e shumë të gjallë. Qerpikët i puliteshin dendur. Ai kishte vënë tërë aftësinë e të dëgjuarit që mund të ketë një teknik: asnjë zhurmë nuk pipëtinte. Rrudhte ballin e ngushtë dhe seç pëshpëriste me vete. Cigarja i digjet mu në gishtat. Po të mos kishin qenë këto shqetësimet e aviacionit, tekniku Niko as që do ta vinte në gojë cigaren.

Shumëherë kishte pritur ai i kapur nga shqetësimi kthimin e aeroplanit. Por këtë radhë zuri ta pushtojë ankthi... Kur aeroplani shkëputej nga toka, tekniku kënaqej dhe në një kohë ndjente edhe xheloz. Aviatorët fluturonin me aeroplanin që pregatitnin duart e tij... Ai mbetej i shurdhër në tokë. Pastaj, tek e shihte të ulej shëndosh e mirë në aerodrom, kënaqësia i shtohet dyfish. Sapo motori fikej, tekniku i fshinte «gushën» sikur donte t'i hiqte «djersët». Me këtë punë merrej një copë herë dhe i vinte mirë. Por, tani aeroplani nuk po dukej. Koha e fluturimit kishte mbaruar qëkur.

«Ç'të jetë bërë? Mos u ka ndodhur gjëkafshë?!..

Eh, sikur të kisha krahë e t'i kërkoja», — mendonte Nikua, i vetëm në mes të fushës, duke u çapitur në atë copë truall të rrahur nga rrotat e aeroplanit, me sytë nëpër horizonte. Nuk i bëhej të largohej nga vendi, por vendosi dhe ja dha një vrapi të papërmbajtur nëpër fushë. Me një frymë u gjend pranë telefonit.

— Aeroplani yt, për shkak të një stuhie që u shfaq papritmas, është ulur shëndosh e mirë në aerodromin fqinjë, — i kishin thënë ata të qendrës dispeçere.

«Po njoftoni, të shkretën, se ma mbushët kokën me thinja», — deshi të thoshte tekniku, por u përmbajt.

«...NË VALBONË AEROPLAN!»

Nuk e kam fjalën për ndonjë fluturim «asësh», por për një detyrë, një detyrë të vështirë, që duhej plotësuar me çdo kusht nga ekipazhi ynë i helikopterit.

Në hartën e fluturimit u hoq me lapës të zi një vijë e gjatë dhe e drejtë. Ajo bashkoi aerodromin me një pikë në skajin më të largët verior të vendit.

— Ky vend quhet Valbonë... — theksoi komandanti. Dhe pastaj nisi të përshkruajë me hollësi detyrën...

Dielli, që deri atëhere qe fshehur prapa reve të murme, doli. Rrezet e tij u derdhën mbi tokë.

Zhurma e motorit, që pilotit i duket si një muzikë madhështore, dëgjohet përreth. Çdo gjë shkon te në rregull. Lartësia e fluturimit 2700 m. Maja e Hekurave, e ndriçuar vende-vende, dukej si gish-trinjë e një dore me thonj të mprehtë.

«Ja ku është shtrati i Valbonës... — belbëzoi mendueshëm komandanti i ekipazhit. — Atje duhet të jetë pika jonë e uljes... po, po, atje është... Shikoni me kujdes. Ja ku duken në shtratin e lumit



Në Valbonë aeroplan

ca fije të holla tymi. . . » Banorët e atjeshëm kishin ndezur zjarr. Nisëm të ulemi poshtë.

«Shikoni me kujdes».

Vendi i uljes ishte si një pus, i thellë dhe i errët. Nga të katër anët male të thepisura, me Jëzercën madhështore në krye.

Tekniku zgjati kokën për të parë: «Pus, tamam pus! . . .

Në mendje të pilotit kaluan shumë mendime, por ato s'lanë asnjë gjurmë. Detyra qëndronte mbi të gjitha: helikopteri, si me mundim, zuri të rrotullohej, duke u ulur poshtë e më poshtë, drejt shtratit të ngushtë të Valbonës. Dukej sikur u krodhëm në errësirën e mugët. Por sytë u mësuan ca nga ca dhe llogaritjet për ulje ishin në rregull. Sido që shtrati i lumit sa vinte e ngushtohej dhe era e fortë e grykës të pengonte, helikopteri manovrohej me guxim poshtë e më poshtë, drejt shtratit të Valbonës. . .

Kur rrotat prekën tokën, u gëzuan të gjithë.

Komandantin nuk e zinte vendi. Unë rrija i menduar dhe ndukja cigaren me dhëmbë, kurse tekniku, me hundën e tij të «ndjeshme», siç i thoshim ne, nuhaste atmosferën. «Oh, nga kemi mbërritur!...» — fliste ai nëpër dhëmbë duke vështuar majat e larta mbi kokë.

Pas pak bëri çap një malësor i moçëm, me mustaqe të shkrifura deri tek veshi. Mbi shpatullat pak të përkulura mbante një pushkë të gjatë. «A jeni, bre burra. . . » — foli prej së largu. Pastaj na dha dorën e ashpër dhe, duke na shikuar drejt pa ndrojtje, u shpreh: «Këtë që bani partia, s'mujti me e ba askush. . . Në Valbonë aeroplan. . . bre, bre!».

BETEJAT VAZHDOJNË

Mëngjezeve, në aerodrom takohen dy pilotë. Njëri, shtatgjatë, i zeshkët, me flokë të përthinjur, mban mbi shpatullat e varura peshën e shumë betejave. Tjetri, fare i ri. Kështu ka qenë edhe thinjoshi dikur. Oh, sa shumë ngjajnë! Dhe sa ngjajnë, si babë e bir!

Prapa tyre, rreshti i aeroplanëve dhe pista e betonitë. Tutje, përqark kësaj fushe, janë ulur shesh malet e **larta**:

«Ç'bëjnë këta pilotë? Ç'bëhet në atë truall plot gjelbërim?»

* * *

Njëzet vjet më parë. Bariu partizan sapo ka zbritur malesh, sapo ka lënë monopatet, ku s'kalojnë veçse shqiponjat fluturimthi.

«Ç'është ky aviacion?!... Si na qenka armë aeroplani?! Armë i them kësaj unë, që vë në sy dhe trak, i tërheq këmbëzën dhe e mbërthen armikun mu në ballë...»

Kështu thotë ai dhe lëmon qytën e pushkës lidhur me gjalmë, ku sapo ka gdhendur me biçak

datën e çlirimit të vendit, betejën e fundit...

«Kjo është armë», — thotë korridoreve, ku e kanë thirrur për ta futur në lista të panjohura për të, për ta dërguar në shkollë.

Filani pilot, filani marinar, tjetri tankist... kë-shtu shkruhet në listat që kalojnë nga një zyrë në tjetrën e që firmosen e vulosen me vula me yll.

«Pilot!...» — mendon ai. «E çdo bëj unë me atë aeroplan? Të trazoj ajrin!...»

Pushkën, lidhur me gjalmë, ku ka gdhendur datën e betejës së fundit, nuk e ndan për asnjë çast. Kur pret korridoreve, ulet dhe e vë mbi gjunjë. Duket sikur e ledhaton. Kur futet zyrove, që i duken të habitshme, ja lëshon tjetrit mu në tryezë: «Ç'na duhen këto të tjerat!... Me këtë fituam goxha luftë...» Kështu mendon, po pastaj i thotë vetes: «Pa dale, këtë e thotë partia...»

Dhe partizani, ish bari, e këmben pushkën lidhur me gjalmë, me një aeroplan modern. Partia i dha në dorë një armë më të fuqishme. Dhe ai nis të shkruajë data të reja.

Aeroplani bëhet për të pjesë e trupit, ashtu siç ka qenë për shqiptarin në shekuj pushka. Veç tani ai ngrihet më lart se kështjellat, më lart se malet, përmbi retë dhe mban në shenjstër horizontet dhe thërret: «Ehej, ju gjaksorë atje tej! Jam këtu. Mban vesh! Po bëtë këtyre anëve, do të përplaseni në kështjellat tona».

* * *

Brezat ecin. Kohët ndryshojnë.

Ëndërron i riu dhe bëhet pilot. Ai, pa hipur në

kabinën e aeroplanit, di shumë gjëra për qiellin, për ajrin, për tokën.

Pilotit ish partizan flokët i janë përthinjur si majat e maleve me borë. Por zemra e tij është prush. Ai i lëshon stafetën të riut: «Kjo është arma që na ka dhënë populli. Kjo tokë na ngriti kaq lart, nga kjo tokë e kemi tërë këtë fuqi».

Dhe ja, piloti i ri çohet në ajër si shqiponja që rreh për herë të parë flatrat. Përpara tij — një provë e rëndë, një e papritur e jashtëzakonshme, malet heshtin; ato sikur mbështeten më mirë brinjë më brinjë dhe mbajnë vesh me zemër të ngrirë:

«Ç'pësoi kjo turbinë reaktive? Pse pushoi kaq befasisht? Ç'do të bëjë tani djaloshi?!»

«Hidhu!» — i kumboi në vesh pilotit të ri. E kjo do të thotë «lëre aeroplanin, lëre atë maqinë që nuk punon më; braktise atë metal, se ne do të nxjerrim tjetër nga dheu... se ti je kapitali ynë më i çmuar, ti nxjerr metal nga dheu, ti futesh galerive dhe tuneleve, ti ngrihesh në qiell, ti je njeriu ynë, je shoku ynë, ti je mishi dhe gjaku i popullit tonë, je ushtar i brumosur me ideologjinë proletare, me traditat më të lashta e më të reja të tokës arbërore».

Pilotit të ri i bëhet sikur një kokë thinjoshe i buzëqesh dhe e porosit...

«Mbaju, mos harro, kjo është arma jonë që ta ka dhënë populli, ne duhet të luftojmë gjer në fund, ta ruajmë... Shqiptari nuk e lëshon armën...»

... Dhe ai, me nofulla të shtrënguara dhe nerva të tendosura e kalon provën e jashtëzakonshme. Ai ulet në tokën e shtrenjtë dhe shkruan datën e fitores në betejën e parë.

MBI QILIMIN E LARMË

Pasi kaloi portën e hekurt, piloti u ndodh në mes të një sheshi të shtruar me zhur të pastër. Atij i dukej sikur vendi u ngushtua dhe të gjithë shikonin vetëm atë. Në dorën e majtë mbante një valixhe të vogël, që ju bë plumb e rëndë. Hapat i hidhte të ngadalta në drejtim të zyrave të komandës dhe mendonte fluturimthi. «Përse shqetësohem? Mos vallë jam akoma kursant? Tani jam pilot... Puna ime është fluturimi».

Ishte mëngjez. Një mëngjez i zyrtë, mjegulli. Por kishte kohë pa rënë një pikë shi.

Teknikët shtynin helikopterët, duke thirrur «Hooo, oop!» për t'i nxjerrë tutje, në fushë.

Piloti ynë, pak i vrejtur në fytyrë, doli nga porta e komandës dhe u ndal tek hekurat e hangarit. Ndezi një cigare, pastaj u mbështet. Sytë i kishte ngulur në një pikë të padukshme, ndërsa truri rrihte mendimet: «Ç'na gjeti! Teori, teori... lamë një shkollë e gjetëm një tjetër...» Një zhurmë e papritur motori gumëzhiu në gjithë fushën.

Pas pak ai, i rrethuar nga shokë të njohur e të

panjohur, qëndronte më këmbë dhe, pa hyrë në bisedë, pohonte mendimet e tyre. Një pilot kuqalosh, që e thërrisnin «teoricien», mbante në dorë një rregullore fluturimi dhe ca harta të rajonit. Ky ngulte këmbë se përsëritjet teorike janë të domosdoshme.

Piloti ynë i ri nuk u përmbajt:

— Çudi! Ca i luten «zotit» për shi, ca për diell. Kështu i thonë kësaj. Ne, të gjithë, sa e lamë shkollën, teorinë...

— Ha, ha, ha! Ti u mërzite që sot! — ja pat njëri.

— Ke kohë të mërzitesh, ohu, prit. Pa na pyet ne. Rregullore, harta, vizorë, lapsa të kuq e blu. Me një fjalë...

— Vajti ora, shokë pilotë. Hajde, në klasë! — e mbylli «teoricieni».

Kështu kaluan ditë të vrejtura e të bukura plot diell. Pilotët, me dashje e padashje (e kam fjalën sidomos për të riun), vazhdonin përgatitjen teorike. Fytyrat e tyre ishin të qeshura, si gjithmonë. Edhe në bisedat e zjarrta, asnjëherë nuk u pa të mungonte humori i hollë. Miqësia e tyre, karakteristikë për njerëzt e ajrit, i gëzonte të gjithë.

Dhe ja, më në fund dita e fluturimit erdhi.

E, ta dini ju se çfarë gëzimi ndjen piloti, kur ngrihet që pagdhirë, merr shlemafonin në dorë e nisët për në aerodrom! Nga ky gëzim, që unë kam fatin ta ndjej e ta shijoj vetë, as vë re se të kalojnë njerëz përreth.

Në aerodrom kishte lëvizje. Vendoseshin flamurë të kuq e të bardhë, tryeza e karrige, ngriheshin antenat e radios, kurse tej, në barin e gjelbëruar, shtrihej starti.

Raketa jeshile çau përperjetë, duke tërhequr pas një bisht, si një komet: qielli i pastër ishte gati të priste me përzemërsi bijt e tij.

Gunëzhima e motorëve jehoi nëpër fushë valë-valë, pastaj u shkëput nga toka e mori lart, qiellin, në efir shpërndareshin zëra të qartë, që buçisnin në radio «Kalova 01... 2000... 6 e 35...»

Në kabinë, në anën e djathtë, rrinte i qetë komandanti dhe, siç e kishte zakon, s'bëhet asnjë lëvizje. Sytë e tij kontrollonin vjedhurazi veprimet e pilotit të ri. «Nuk ka të sharë, e drejton shumë mirë maqinën, — mendonte, — po i duhet ulur pakëz hunda...»

Përposh tyre, rrëshqiste toka si një qilim i madh laraman. Atë qilim e ndanin në pjesë-pjesë kanalet e lumenjtë dredharakë. Malet dukeshin sikur kishin hedhur qafës ndonjë shall mëndafshi. Ato i mbështillte mjegulla mëngjezore. Ndërsa çuka e Tomorrit, e rrethuar nga një zinxhir resh ngjy-rë rozë, ngjante si një kokë e zbukuruar me kurorë luledelje.

Më në fund komandanti pyeti me radio: — Ku ndodhemi? Piloti u drodh, sikur e fshiku era e fortë, që fërshëllente në bort. Instrumentat për një çast ndryshuan tregimin. Ai shikoi hartën.

— Në fushën e Myzeqesë... — foli mbyturazi, duke fshehur pasigurinë për t'u përgjegjur më tej.

Pastaj pyetjet rrodhën varg:

— Mbi cilin lumë?

Piloti shtypi sustën e radios: — «Ë, ëëë... mbi Seman».

Toka rrëshqiste përposh tyre. Tej, më të djathtë, deti i purpurt dukej si një kadife blu. Buzë tij ngrihej një brez pylli bojë plumbi.

— Po ai, atje përpara...? Po ajo qendër e re banimi?... Po kënetat ku është? Shih, sa ndryshime janë bërë! — desh të thosh komandanti. «Më kapi, po më dalin dy Semane. Po ky ç'është?» — murmuriste piloti.

— Ky është Semani i vërtetë, kurse atje prapa ishte rrjedha e vjetër, — përfundoi komandanti.

Pamja përposh tyre ndryshonte. Dualën kodra të veshura me një ngjyrë si shegë e mykur, pastaj male të përhimta dhe përsëri fushë. Aerodromi po afrohej. Aeroplani humbiste lartësinë. «T-ja» e uljes zbardhonte në barin e gjelbër. Toka afrohej, afrohej dhe rrëshqiste më shpejt. Motori gumëzhinte, ushëtima e tij mbuloi fushën. Pastaj s'kaloi shumë dhe ajo u pre njëherësh.

Nga kabina doli komandanti dhe pas tij piloti. Ata hoqën shlemin nga koka e dëgjonin fëshfërimën e barit nën këmbë. U dukej sikur sundonte një qetësi e mbinatyrshme. Dhe ata vendosën të mos e prishnin këtë heshtje.

«Nesër e shohim çdo gjë, në kritikën e fluturimit» — mendoi komandanti dhe, sikur t'i kishte thënë me zë këto fjalë, i bëri shenjë me dorë pilotit të largohej.

«Le të mendohet vetë një herë...»

Era e freskët e detit përkëdhelte fytyrat e lodhura dhe ftohte motorët e nxehtë.

ATJE KU TOKA DHE QIELLI JANË NJËSOJ TË SHTRENJTË

Aviatorët, kur janë në tokë, shikojnë përherë qiellin e s'ja ndajnë sytë. Vëzhgojnë! Kur janë në qiell, shikojnë tokën. E ke vënë re këtë?

Kështu më thoshte një ditë një nga shokët e mi të armës. Dhe unë mendoj se kështu është e s'ka si të jetë ndryshe, përderisa qielli dhe toka janë njësoj të shtrenjtë për aviatorin.

Pilotët tanë kanë një privilegj, që ndoshta askush nuk mund t'ja sigurojë vetes. Ata i shikojnë të parët të gjitha ç'ndodhin poshtë, tej e tej horizonteteve të Republikës. Para syve të tyre përditë, brinjë malesh, në prehër të fushave e buzë detit, shfaqen trajtat e konturet e veprave të socializmit. Aviatorët detyrohen t'i vënë atyre emra të përafërt e të pasaktë. Kështu i thërresin, gjersa i merr gazeta, dhe veprat zënë vend e mbeten të «pagëzuara» me emrat e vërtetë. Hartat ajrore nuk i kanë shumë prej objekteve të reja. Madje në to nuk figurojnë qendra të mëdha banimi, si ferma, kooperativa bujqësore, qendra industriale, që janë sa

një goxha qvtet. Këto pasaktësi të hartave i vënë përpara telasheve fluturuesit. Por s'kanë ç'bëjnë edhe topografët e shkretët! Sa mbarojnë në një rajon, në tjetrin ka ndryshime. S'arrijnë. Veprat tek ne çelin e lulëzojnë çdo ditë, më keq se luledelet në muajin e tyre.

Edhe malet, të pështjella me bandazhe tarra-cash, shpesh i vënë në dilemë pilotët: është apo s'është Biza, Polisi, Mali i Thatë, kodrat e rivierës?...

Ndërsa rrugët ajrore nuk pengohen nga asgjë, ato kryqëzohen mbi peizazhin e Republikës duke u dendësuar. Dhe aviatorët, ndonëse të proekupuar së tepërmi për orientimin, e kanë këtë privilegj që të shohin si në pëllëmbë të dorës se qysh merr pamje të ndryshme fytyra e atdheut për ditë e për çdo orë.

Takojmë pilotët

Bëmë një copë udhë gjersa zbritëm në aerodromin «N». Qemë nisur shpejt dhe gjetëm ende mjegullën e mëngjezit në ato anë. Kjo kishte bukurinë e saj, që ne nuk e prisnim. Të gjitha sendet përçark mezi shquanin dhe vargmalet, ca më tutje, ngjanin sikur lundronin mbi atë afsh të kaltër, që shtyhej e përndahej plogët, sipas hovit të erës që frynte nga lindja. Për të arritur shpejt, i ramë shkurt dhe kaluam prerazi me pistën, me ato pllaka të mëdha betoni, që shtrojnë brezin e gjatë të uljes e të ngritjes së aeroplanëve. Këtu të zë syri plot gjurmë rrotash. Atë kohë që po çapiteshim aty, ndjeva se sa pranë qëndron qielli përmbi këtë brez. «Këtu, — thashë me vete, — bëhet njësh qie-

Ili me tokën. Dhe tamam këtu zë fill mbrojtja e hapësirave tona qiellore. Që këtej nisin llogoret dhe lartësohen shtresë pas shtrese, gjer atje ku vëzhgon syri i shqipeve. . . »

Ndërsa unë mendoja këto, të tjerët krahasonin pistën e këtushme me autostradat që u ishte dhënë rasti t'i shikonin ndonjëherë.

— Këtu mund të fluturojë edhe maqina, — ja bëri shoferi ynë.

— Si në film, — ja pati njëri.

— Mbërritëm në kohë, — thashë.

Gjetëm një grup aviatorësh të mbledhur tok, në një pushim të shkurtër. Siç i thonë «pushim aviacioni». U përshëndetëm. U përqaftuam. Madje u puthëm nxehtësisht, sipas sjelljeve të aviatorëve luftarakë.

Aty në mes të pilotëve ishte dhe një fotoreporter, që na qenkësh mik i vjetër i tyre, sido që pati kaluar peripeci në fluturime. Një nga djemtë aviatorë sikur të na kishte blerë mendimet tha:

— Ai ka provuar ca kohë më parë bukurinë dhe ashpërsinë e fluturimit!

— Romantikën revolucionare të qiellit, — shtoi një tjetër.

Fotoreporteri u ngrit në dy këmbët e hapura dhe, si për t'i dhënë rëndësi vetes, nxori përpara nja dy aparate dhe blicin.

— Hajdeni, — tha.

Pa e bërë dysh fjalën e fotoreporterit babaxhan, u ngritën nja tre a katër aviatorë dhe muarën rrugën për nga vendqëndrimi i avionave.

— Ki kujdes, Ilo! Bardhin ule më gjunjë, se do ngjasë si shtyllë e tensionit të lartë.

Bardhi, aviatori më i gjatë ndoshta në tërë aviacionin tonë, ecte me kokën ulur, duke tundur kokoren që mbante në dorë.

Këtu takuam të vjetër e të rinj. Takuam nga ata, që sapo kanë nisur të thinjen dhe nga ata që sapo kanë vënë brisk në faqe. Vetëm nga veteranët s'mundëm të takonim. Nga ata që zbritën nga malet dhe hipën në kabinën e aeroplanit me shallin e kuq partizan pas qafe. Po gjetëm gjurmët e tyre: Gez-dari, me thinjat e dirsura në tëmtha, vepron ashtu siç bënte komandanti i tij. Ai udhëheq siç kërkohet në aviacion me shembullin personal. Komisari na foli me dashuri për gjithë aviatorët.

— Pilotët tanë, — tha ai, — e ruajnë si sytë e ballit teknikën moderne, që u ka dhënë në dorë partia dhe populli.

Ai zuri të tregonte për një rast, kur, gjatë një përmbytjeje, kërcënohej nga dëmtimi teknika fluturuese, aeroplanët. Piloti i ri B. Josa, i zhveshur, në mes të ftohtit, qe hedhur me not në anën tjetër, nëpër ujin e furishëm, për t'u gjendur në çdo rast pranë maqinës së tij luftarake. Siç mësuam, ky aviator, i lidhur së tepërmi me aeroplanin e tij supersonik, ka fituar një përvojë të mirë në teknikën e pilotimit. Ai bën një qitje të shkëlqyer kundër objekteve tokësore.

— Ja, — na tha komisari, — shkruani për Mahmutin. Ai është ndeshur drejtpërdrejt me armikun dhe ka ç'u tregon vartësve.

Kapërcyem një kanal dhe u gjendëm pranë aeroplanit, mbi të cilin koha kishte bërë punën e vet. Në bortin e tij akoma lexoheshin qartë shkronjat e zeza: «US. AIR FORCE», që ngjanin si dhëmbë të prishur në një gojë të çaplyer.

— Ky aeroplan bën punë të madhe po të vendoset në një udhëkryq...

Përmbi atë metal të përpunuar kushedi në ç'uzinë të imperializmit, qëndroi fitimtar piloti ynë revolucionar. Vite të shkuara ai u mat me këtë makinë ajrore, që ishte sulur si përbindësh hapësirave e që kësaj here «ju dha rasti» të dergjej në këtë cep të aerodromit shqiptar.

Rrugës, kur po ktheheshim nga aerodromi «N», më shkoi mendja tek piloti i ri B. Sina. Te akti i tij. Ç'forcë e madhe fshihet brenda këtij të riu trupimët, që nuk e braktisi aeroplanin në situatë aq të vështirë, po e uli në aerodrom me motor të shuar.

Zemër e fortë

— Nuk di si ta shpjegoj, — më thoshte aviatori S.Prifti. Por mua më ngjan se, kur qielli është i kthjellët e pa një grimcë reje, është vështirë ta përfytyrosh të zymtë e të turbulluar; me re të ulëta sa s'bëhet, me shi të përzier me mjegull...

Aviatori me të cilin bisedoja, donte të thoshte me këto fjalë se nuk është lehtë të provosh emocionet e një piloti, kur bie në kushte të tilla meteorologjike. Bile ka të ngjarë që edhe vetë ai që i ka jetuar ato, pas disa ditësh, ndoshta edhe pas disa çastesh, të mos i ripërtërijë dot.

Biseda jonë zhvillohej rreth një fluturimi të vështirë që kishte kryer piloti V.Andoni.

Atë ditë, në aerodromin «N» aeroplanët ngriheshin, fluturonin drejt reve, çanin përmes tyre dhe dilnin lart, mbi to, nën rrezet e diellit. Pasi plotësonin detyrën, ata zbrisnin poshtë reve, linin atje

sipër rrezet e diellit dhe tani para syve të pilotëve shfaqej relievi i ashpër malor, i pështjellë nga një tymtajë e vrërët, me lagështirë. Atë ditë, asnjeri, përveç pilotëve, nuk kishte mundësi të shikonte qoftë edhe një rreze dielli. Dielli kishte dalë qëkur, por vetëm mbi re.

Gjë e bukur është të dalësh mbi re. Mbi re me një aeroplan të shpejtë, të armatosur mirë, e të bësh roje atje lart... Por këtë punë mund ta bëjë ashtu siç kërkohet vetëm ai pilotë që ruan ndjenjën e përgjegjësisë ndaj atdheut e partisë në çdo çap, në çdo metër lartësie, në çdo sekondë. Për këtë kërkohet një përgatitje teorike dhe praktike e gjithanshme këtu, në tokë. Pastaj atje lart, në qiell, kur ngrihen e bëjnë roje aviatorët, të gjitha ç'bëhen në tokë kthehen në një formulë: zgjuarësi — guxim — gjakftohtësi.

Kur u ngrit lart, aviatori. V. Andoni nuk pati ndonjë vështirësi. Mirëpo qielli ka plot të papritura. Retë u varën në çast dhe thujse u përleshën me atë tymtajën, që hiqej zvarrë dhe që endej në të katër anët e horizontit, përmbi relievi. Toka sikur fshehu konturet e saj dhe u shkri. Horizontet u qasën fare pranë njëri-tjetrit.

Kështu që moti e priti ashpër aviatorin. V. Andoni që kthehej në aerodrom. Ai vështroi me kujdes shigjetat e instrumentave, që lëvrinin të koordinuara, dëgjonte nën kokore zëra të qetë, komanda, shifra, tinguj që futeshin pareshtur në kabinë, duke u ngjitur nga toka. Shikonte vetëtimthi përçark, por asgjë. Asgjë nuk dallonte veç krahëve të aeroplanit të tij. Kaluan edhe 1000 metrat. Mbetën 800, 600 metra...

Toka duhej të qe shfaqur. Shigjeta e lartësisë lëvrinte indiferente në shifrën 400, 300, 200 metra... Toka qe fshehur keqas. Edhe aeroplani po ashtu keqas ishte kredhur në re, saqë udhëheqësi i fluturimeve, që gjer atë kohë jepte vetëm komanda të rëndomta e qetësuese, rrotullonte shikimin me padurim.

Minutat ose, më mirë të themi, sekondat e para janë shqetësuese për pilotin në kësi rastesh, gjersa vendos, dhe ai zakonisht vendos fët e fët. Pas vendimit çdo gjë është e lehtë.

Kështu kishte bërë edhe V. Andoni. Ai vendosi dhe u ul në aerodrom pa përfillur rrezikun, ndonëse toka, aerodromi, mezi u shfaq në një lartësi fare pak metrash. Turbina vërshëlleu në betonkë si përhera. Zemra e pilotit rrahu fort. Ai u përçafua me tërë shokët që e ndihmuan nga toka.

Helikopteri kërkohet në det

Një herë dëgjoja tek zhvillohej në mes aviatorëve një bisedë afërsisht si kjo:

— Kemi shpëtuar shumë shoferë nga vërshimet e lumenjve...

— Ç'kërkojnë shoferët në ujë? Të jenë peshkatarë, epo hajde...

— Shoferët janë të lidhur me çdo gjë mbi tokë e nën tokë...

S'kaluan veçse disa ditë dhe peshkatarët kërkuan ndihmën e helikopterit.

Deti ishte i egërsuar. Varka e vogël përplasej si lëvozhgë arre nëpër dallgët e marrosura. Helikopteri u duk se nuk do të qëndronte dot pezull mbi

të e të merрте në bort njerëzit e gjendur befasisht në rrezik. Era e fortë e shtynte helikopterin, dallgët vërvitnin tutje varkën. Përleshje në det e në qiell. Por ekipazhi, i komanduar nga piloti E. Mehmeti, nuk u praps.

«O të fundosemi edhe ne, o të shpëtojmë ata», kështu dukej sikur thoshte ajo vendosmëri e tyre. Pilotët bënë të pamundurën dhe i tërhoqën njerëzit në bortin e helikopterit. Ja hoqën detit nga goja e çaplyer. Ata shpëtuan vëllezërit e tyre dhe u kthyen prapë fluturim mbi egërsinë e detit, pranë gëzimit të shokëve.

Aerodromi fushor

Ka vite që aty, pranë kodrave, jo larg qytetit të Lushnjës, është hapur një aerodrom fushor. Ky aerodrom nuk ka emër ende dhe ndoshta nuk ekziston në ndonjë farë dokumenti si tërë aerodromët. Por atje, sapo hyn pranvera, nis të gjëmojë një motor aeroplani, që ngrihet e ulet dhjetëra herë në ditë. Ai aeroplan i gjelbër, me t'u ngritur, kapërcen trasenë e re të hekurudhës dhe rrafshohet përmbi parcelat me të lashta. Fluturon fare ulët, thuase prek bisqet e grurit, dhe lëshon nga ~~kra~~rahët një vesë të vrullshme herbicidi.

Piloti i vjetër. Z.Durmishi i njuh me pëllëmbë sektorët; edhe agronomët i njuh e i ka bërë miq. Ai shqetësohet shumë për punën dhe bën çmos që herbicidi të mos bjerë në bimët që dëmtohen, po tamam në barërat e këqia, ashtu siç duhet të bjerë bomba me saktësi mbi armikun.

— Është punë e vështirë!.. Po duhet bërë me-

doemos, se ka nevojë bujqësia, — thotë ai. Dhe duke qeshur, shton: — Do të isha gati të shkoja edhe nëpër gurët e Bratajt, të ndihmoja lebërit e mi. ..

Kur kalon njeriu nëpër pistat e aerodromëve, e ndien fare mirë se qielli dhe toka janë fare pranë. Bëhen njësh. Bëhen njësoj të shtrenjtë. Aviatorët rrinë nëpër postet e tyre. Llogoret e tyre zënë fill që nga toka mëmë dhe lartësohen shkallë — shkallë tutje stratosferës.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

| | Faqe |
|---|------|
| Piloti i fermës | 3 |
| Kur do ta festojmë vitin e Ri? | 12 |
| Ëndërra e aviatorit Sulo | 20 |
| Aeroplani dhe brigadierja | 34 |
| Përmes verimesh | 43 |
| Udhëve të braktisura | 52 |
| Një fluturim i zakonshëm | 65 |
| Mos më harro, komandant!.. .. | 72 |
| Teknikët | 76 |
| «... Në Valbon aeroplan!» | 82 |
| Betejat vazhdojnë | 85 |
| Mbi qilimin e larmë | 88 |
| Atje ku toka dhe qielli janë njësoj të shtrenjtë | 92 |